



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KUVENDI

LEGJISLATURA IX - SEANCA E DITËS SË ENJTE, 19 KORRIK 2018, TIRANË

PROCESVERBAL

**SEANCËN E DREJTON  
KRYETARI I KUVENDIT  
GRAMOZ RUÇI**

*(Seanca filloi në orën 10:00)*

**Rendi i ditës:**

1. Miratimi i procesverbaleve të seancave plenare të datave 05.07.2018 dhe 09.07.2018 *(neni 44 i Rregullores)*

2. Njoftimi i projektligjeve të depozituara në Kuvend *(neni 44, pika 3, i Rregullores)*

3. Raporti vjetor i veprimtarisë së Kontrollit të Lartë të Shtetit për vitin 2017 *(neni 103 i Rregullores, votim me shumicë të thjeshtë)*

Shprehet titullari i institucionit *(jo më shumë se 60 minuta)*.

Shprehet Komisioni përgjegjës për Ekonominë dhe Financat.

Pyetje

Diskutime *(nëse kërkohet me shkrim nga një komision i përhershëm, një kryetar grupi ose 10 deputetë)*

*(Shprehen grupet parlamentare.)*

Koha e votimit

4. Projektligji “Për një ndryshim dhe shtesë në ligjin nr. 8378, datë 22.07.1998 “Kodi Rrugor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar” *(neni 81/2 i Kushtetutës dhe nenet 73-77 të Rregullores, votim me shumicë prej 3/5-ve të të gjithë anëtarëve të Kuvendit)*

Pyetje

Shprehet Komisioni përgjegjës për Sigurinë Kombëtare.

Diskutime

*(Shprehen grupet parlamentare.)*

Koha e votimit (në parim, nën për nën dhe në tërësi)

5. Projektligji “Për ratifikimin e marrëveshjes me vendin pritës ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Fondit të Ballkanit Perëndimor” *(nenet 73-77 të Rregullores, votim me shumicë absolute)*

Pyetje

Shprehet Komisioni përgjegjës për Politikën e Jashtme.

Shprehet për dhënie mendimi Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut.

Diskutime

*(Shprehen grupet parlamentare.)*

Koha e votimit (në parim, nen për nen dhe në tërësi)

6. Projektligji “Për ratifikimin e marrëveshjes së ndryshimit ndërmjet Republikës së Shqipërisë, duke vepruar nëpërmjet Këshillit të Ministrave, dhe Trans Adriatic Pipeline AG, lidhur me marrëveshjen me qeverinë e vendit pritës” *(nenet 73-77 të Rregullores, votim me shumicë absolute)*

Pyetje

Shprehet Komisioni përgjegjës për Veprimtaritë Prodhuese, Tregtinë dhe Mjedisin.

Shprehet për dhënie mendimi Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut.

Shprehet për dhënie mendimi Komisioni për Politikën e Jashtme.

Diskutime

*(Shprehen grupet parlamentare.)*

Koha e votimit (në parim, nen për nen dhe në tërësi)

7. Projektligji “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” *(neni 81/2 i Kushtetutës dhe nenet 73-77 të Rregullores, votim me shumicë prej 3/5-ve të të gjithë anëtarëve të Kuvendit)*

Pyetje

Shprehet Komisioni përgjegjës për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut

Diskutime

*(Shprehen grupet parlamentare.)*

Koha e votimit (në parim, nen për nen dhe në tërësi).

8. Projektvendimi “Për miratimin e ndryshimeve të strukturës dhe organikës së Komisionit të Prokurimit Publik” *(nenet 73-77 të Rregullores, votim me shumicë të thjeshtë)*

Shprehet Komisioni përgjegjës për Ekonominë dhe Financat.

Diskutime

*(Shprehen grupet parlamentare.)*

Koha e votimit

9. Projektvendimi “Për një ndryshim në strukturën dhe organikën e Zyrës së

Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale” *(nenet 73-77 të Rregullores, votim me shumicë të thjeshtë)*

Shprehet Komisioni përgjegjës për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut.

Diskutime

*(Shprehen grupet parlamentare.)*

Koha e votimit

10. Projektvendimi “Për ngritjen e nënkomisionit parlamentar “Për ndjekjen dhe mbikëqyrjen e zbatimit të ligjit nr. 12/2018, “Për vlerësimin kalimtar dhe periodik të punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës dhe Shërbimit për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat në Ministrinë e Brendshme” *(nenet 73-77 të Rregullores, votim me shumicë të thjeshtë)*

Koha e votimit

11. Për votim:

Projektligji “Për profesionin e avokatit në Republikën e Shqipërisë” *(nenet 73-77 të Rregullores, votim me shumicë të thjeshtë)*

12. Diskutime për çështje jashtë rendit të ditës *(neni 45 i Rregullores)*

Koha e diskutimeve deri në 60 minuta

**Gramoz Ruçi** – Ftohet media të jetë në sallë.

Atëherë, fillojmë, të nderuar kolegë.

Seancën e ditës së sotme e deklaroj të hapur.

*(Pasi lexon rendin e ditës)*

Lidhur me procesverbalin, ka vërejtje? Nuk ka.

Miratohet.

Ju njoftoj se janë propozuar tri projektligje nga Këshilli i Ministrave, dy prej të cilëve janë ratifikime. Nga deputetët është depozituar kërkesa e bashkëkryetarëve të Komisionit të Posaçëm për Reformën Zgjedhore për shtyrjen e afatit të veprimtarisë së komisionit. Titujt i keni të gjithë përpara te njoftimet. Materialet, si gjithmonë, do t'i gjeni në faqen zyrtare të Kuvendit në internet.

Fillojmë me pikën e parë të rendit të ditës, me raportin vjetor të veprimtarisë së Kontrollit të Lartë të Shtetit.

Ftoj zotin Bujar Leskaj, kryetar i Kontrollit të Lartë të Shtetit, të marrë fjalën.

**Bujar Leskaj** – I nderuar zoti Kryetar i Kuvendit,

Të nderuar zotërinj deputetë,

Së pari, më lejoni t'ju falënderoj që, pas një sërë vitesh, Kuvendi i Shqipërisë ka marrë një vendim shumë të dobishëm për të dëgjuar në seancë plenare të gjithë drejtuesit e institucioneve kushtetuese dhe institucioneve të tjera të pavarura!

Filozofia e punës sonë, si Kontroll i Lartë i Shtetit, në këto vite është bazuar në Kushtetutën e vendit, në ligjin organik të KLSH-së dhe në korpusin ligjor në fuqi, në standardet ndërkombëtare të auditimit, në rezolutat e Kombeve të Bashkuara për mbështetjen që kuvendet duhet t'u japin institucioneve supreme të auditimit, kuptohet, edhe në rezolutën e Kuvendit të Shqipërisë për Kontrollin e Lartë të Shtetit. Filozofia jona ka qenë modernizimi i institucionit në punën audituese, si dhe thellimi i transparencës dhe llogaridhënies për një qeverisje të mirë dhe në luftë kundër korrupsionit, duke vepruar nën moton: "Kontroll i Lartë i Shtetit – shërbëtar i qytetarit dhe agjent i Kuvendit".

Mbi bazën e kësaj filozofie, ne ndërnuam strategjinë e zhvillimit 2013-2017, e cila ishte në një linjë me strategjitë e zhvillimit të INTOSAI-t dhe EUROSAT-t, organizata ndërkombëtare ku ne aderohet prej vitesh.

Me kënaqësi, në fund të vitit 2017 edhe nga institucionet tona simotra u konstatua që strategjia është përmbushur në masën mbi 90%.

Strategjia e Kontrollit të Lartë të Shtetit 2013-2017 përcaktoi gjashtë qëllime strategjike kryesore, të cilat mbuluan dimensionet më të rëndësishme të zhvillimit të institucionit. Këto gjashtë qëllime strategjike ishin: zhvillimi i kapacitetit institucional të KLSH-së; rritja e kapaciteteve audituese dhe e cilësisë së auditimit; përmirësimi i cilësisë dhe shtimi i numrit të auditimeve të performancës; zhvillimi dhe konsolidimi i auditimeve të teknologjisë së informacionit dhe përdorimi i IT-së në auditim; rritja e kontributit të KLSH-së për qeverisje të mirë nëpërmjet luftës kundër korrupsionit, si dhe rritja e ndikimit të rolit të KLSH-së nëpërmjet komunikimit dhe bashkëpunimit.

Kjo strategji ishte guri i themelit për ndryshimet që pasojnë në të gjitha dimensionet e punës së institucionit tonë, ku më kryesoret, pa dyshim, janë: ligji organik nr. 154 i vitit 2014 i Kontrollit të Lartë të Shtetit, i cili konfirmoi plotësisht funksionimin e Kontrollit të Lartë të

Shtetit në të njëjtën linjë me standardet ndërkombëtare të auditimit, sipas vlerësimit të *DG Budget*; konsolidimin profesional nëpërmjet manualeve të auditimit dhe trajnimit të stafit; hapjen institucionale nëpërmjet botimeve shkencore në shtypin e përditshëm dhe komunikimin me palët e interesit, sikurse edhe bashkëpunimet me institucionet supreme të auditimit në Europë dhe më gjerë, bazuar nën moton e INTOSAI-t: "*Experientia mutua, omni bus prodest* – Eksperiencia e përbashkët u shërben të gjithëve".

Në këtë vit të fundit të strategjisë, në vitin 2017, ne paraqesim performancën e institucionit tonë përpara Kuvendit të Shqipërisë mbështetur në kornizën e matjes së performancës së institucioneve supreme të auditimit, dokument ky i miratuar në kongresin e fundit ndërkombëtar INTOSAI 22 në Abu Dhabi, në dhjetor të vitit 2016.

Korniza e matjes së performancës është një metodologji moderne që analizon në thelb lidhjen shkak-pasojë të faktorëve që përcaktojnë suksesin e aktivitetit auditues. Është në thelb një auditim performance i drejtuar nga vetja, një auditim me sy kritik, reflektim kritik, periodik për t'u përmirësuar dhe për t'u udhëhequr nëpërmjet shembullit.

Metodologjia mbështetet në sistemin e vetëvlerësimit dhe/ose vlerësimit nga institucione të tjera të auditimit. Edhe ne pikërisht këtë kemi bërë, e kemi mbështetur atë për sa i përket pavarësisë së institucionit në bazë të një procesi *peer review*, proces rishikimi mes kolegësh me Gjykatën Austriake të Auditimit, e cila është njëherazi edhe sekretare e Përgjithshme e INTOSAI-t, si dhe me kolegët polakë për pjesët e tjera.

Fushat e matjes së performancës institucionale janë: pavarësia dhe korniza ligjore; qeverisja e brendshme dhe etika, cilësia e auditimit dhe e raportimit; menaxhimi financiar, asetet dhe strukturat mbështetëse; burimet njerëzore dhe trajnimi, si dhe komunikimi dhe menaxhimi i palëve të interesit.

Secila prej fushave përmban parametra, tregues specifikë (25 në total), të inkuadruar në një matricë. Çdo parametër përmban dy deri në katër dimensionet, të cilat synojnë të ballafaqojnë kriteret e specifikuar nga referencat përkatëse, sipas standardeve ISSAI apo dokumenteve bazë

të INTOSAI-t, EUROSAT-t apo organizatave homologe, si dhe organizatave të tjera ndërkombëtare të auditimit suprem, me në fokus performancën institucionale!

Treguesit e agreguar dëshmojnë se Kontrolli i Lartë i Shtetit për vitin 2017 ka një performancë mbi nivelin mesatar. Konkretisht, për tre nga gjashtë fusha vlerësimi, përkatësisht fusha 3, 4 dhe 5, merr vlerësimin “4” nga 4, që është maksimumi, ndërsa për tri fushat e tjera merr vlerësimin “3” nga 4, që është maksimumi.

Më në detaje kjo performancë cilësohet si vijon:

Në tryezat tuaja, me lejen e Kryetarit të Kuvendit, ne kemi vendosur edhe një doracak, i cili jep indikatorët e performancës së institucionit tonë për vitin 2017, si dhe bën një krahasim ndërmjet gjashtë vjetëve (2012-2017) me dhjetë vjet (2002-2011).

Performanca dhe korniza ligjore

Performanca e kësaj fushe u mat dhe u vlerësua nga Gjykata Austriake e Auditimit nëpërmjet procesit “*peer review*”, proces rishikimi mes kolegësh. Gjykata në fjalë gjykon: “K Kontrolli i Lartë i Shtetit në Shqipëri ka një kornizë rregullatore, që garanton pavarësi të përshtatshme në realizimin e plotë të misionit dhe detyrimeve kushtetuese. Kjo kornizë sanksionon pavarësinë organizative në planin e auditimeve në strukturën dhe stafin e nevojshëm”.

Sipas Gjykatës, ligji ka qenë një hap i rëndësishëm për të sanksionuar si aksesin në informacion, ashtu edhe të drejtën dhe detyrimin për raportim, dimensione këto që kanë përmirësuar ndjeshëm performancën institucionale.

Nisur nga aspekti i së drejtës, dimensionet që përcaktojnë mandatin e KLSH-së vlerësohen me “4”, me vlerësimin maksimal. Gjykata Austriake e Auditimit konkludoi se aktiviteti i KLSH-së është në përputhje me Deklaratën e Limës (ISSAI-n 1), pra me standardin ndërkombëtar nr. 1; me Deklaratën e Meksikos (ISSAI-n 10), atë për pavarësinë e institucioneve supreme të auditimit, si dhe me ISSAI-n 11.

Përveç vlerësimit pozitiv, kolegët e Gjykatës Austriake të Auditimit cilësuan si aspekt që ndikon në forcimin e pavarësisë reale edhe pavarësinë financiare. Duke vlerësuar arritjet e KLSH-së, dhanë edhe sugjerime, të cilat

besoj se edhe Kuvendi i Shqipërisë do t’i ketë parasysh në të ardhmen.

Edhe sipas kornizës ligjore, institucioni ka mandat të mjaftueshëm dhe akses të plotë në informacion. Gjatë vitit 2017 kanë qenë disa raste sporadike ku ne kemi hasur pengesë në informacion, por këto raste, në bashkëpunim me Komisionin Parlamentar për Ekonominë dhe Financat apo drejtuesit e ekzekutivit, jemi përpjekur t’i zgjidhim apo t’i tejkalojmë, me përjashtim të një rasti, që nuk kemi arritur ta zgjidhim.

Qeverisja e brendshme dhe etika

Qeverisja e brendshme është vlerësuar në përputhje me kërkesat e standardeve ISSAI 10, 12, 20, 30 dhe 100. Sistemi i vetëvlerësimit bazohet në matjen e ciklit të planifikimit strategjik, ku përfshihen: plani strategjik, plani vjetor, planifikimi organizativ dhe monitorimi, si dhe raportimi i performancës institucionale.

Vlerësimi cilëson se KLSH-ja është drejtuar duke dhënë shembullin e mirë, duke synuar të jetë organizatë model, si dhe duke promovuar transparencën dhe llogaridhënien.

Mjedisi i kontrollit organizativ është vlerësuar nëpërmjet dimensioneve të lidhura me mjedisin e kontrollit të brendshëm, si etika dhe integriteti, sistemi i kontrollit të brendshëm, sistemi i kontrollit të cilësisë dhe sistemi i sigurimit të cilësisë. Të gjitha këto dimensionet janë matur në përputhje me kërkesat e udhërrëfyesve metodologjikë, modelit COSO, modelit INTOSAINIT e të tjerë.

Këta tregues vlerësohen me 4 pikë kundrejt 4, përveç sistemit të kontrollit të cilësisë, ku duhet të përmirësojmë instrumentet metodologjike për matjen e risqeve që lidhen me cilësinë.

Mjedisi

Strategjia jonë për zbatimin e një sistemi efektiv të etikës dhe integritetit për sa i përket mjedisit të kontrollit të brendshëm, etikës dhe integritetit, u fokusua në tri shtylla kryesore: hartimi dhe konsolidimi i kuadrit rregullator mbi etikën dhe integritetin, ku KLSH-ja renditet ndër të parat e institucioneve supreme të auditimit që, në mënyrë vullnetare, që nga viti 2014, ka adoptuar metodologjinë e vetëvlerësimit të integritetit, INTOSAINIT-it, e cila zbatohet nga ESAI holandez, e konsideruar si një nga metodat

inovative dhe të efektshme me impakt në zhvillimin e politikave të integritetit.

Institucioni ynë dhe kontributin e tij modest në hartimin e draftit të ri të standardit ISSAI 30 “Kodi i etikës”, i cili u miratua si dokument zyrtar në kongresin INCOSAI 22 në Abu Dhabi, në dhjetor të vitit 2016.

Në korrik të vitit 2017 Kontrolli i Lartë i Shtetit u bë anëtar i grupit të punës së EUROSAT-t ‘Mbi rolin e institucioneve supreme të auditimit në përhapjen e kulturës etike në sektorin publik’, i cili udhëhiqet nga SAI i Hungarisë. Nëpërmjet pjesëmarrjes aktive në këtë grup, ne synojmë zbatimin e auditimit të etikës dhe integritetit në subjektet e auditimit të sektorit publik.

Shtylla e dytë është menaxhimi i etikës dhe integritetit. Në këtë aspekt kemi kryer trajnime intensive, që kanë synuar edukimin e punonjësve të institucionit me frymën e standardeve etike dhe vlerave morale. Megjithatë, gjykojmë se kemi ende shumë për të bërë.

Shtylla e tretë është ushtrimi i funksioneve mbikëqyrëse dhe kontrolluese, investiguese dhe ndëshkuese ndaj sjelljeve në shkelje të etikës dhe integritetit. Për periudhën 2012-2017 komisioni i etikës së institucionit ka larguar dhjetë punonjës nga detyra për shkelje të etikës dhe integritetit.

Gjatë gjithë kësaj periudhe, pra gjatë këtyre gjashtë vjetëve, pavarësisht largimeve të shumta, asnjë punonjës nuk është ankuar për largime për motive politike.

Nëpërmjet shkresës së datës 18.11.2016, ne i kemi kërkuar inspektorit të Përgjithshëm të ILDKPKI-së kryerjen e verifikimit të plotë e të thelluar lidhur me deklarimin e të gjithë punonjësve të KLSH-së, që mbartin detyrimin ligjor për deklarimin e interesave private, në nivel drejtori dhe kryeaudituesi. Nga ILDKPKI-ja u kryen verifikimet, bazuar në kërkesat e ligjit përkatës, për 28 drejtues të KLSH-së dhe në përfundim të këtij procesi nuk rezultuan shkelje të kuadrit rregullator.

Në vitin 2018, mbështetur në miratimin që parlamenti i bëri Kodit të Etikës së Deputetëve, pranë Kontrollit të Lartë të Shtetit u miratua kodi i etikës së kryetarit, i cili njeh si shtyllë kryesore, pranon pa asnjë kondicion se kryetari i KLSH-së në veprimtarinë e tij njeh dhe zbaton pa asnjë kusht Kodin e Etikës së Deputetit.

Cilësia e auditimit dhe raportimi

Nëpërmjet këtij dimensionimi kemi vlerësuar cilësinë e punës audituese, si dhe rezultatet e auditimit për të tria llojet e auditimeve: auditim financiar, auditim i performancës dhe auditim i përputhshmërisë.

Gjatë periudhës janar-dhjetor të vitit 2017 Kontrolli i Lartë i Shtetit ka kryer 156 auditime nga 154 të planifikuara, nga të cilat 92 janë auditime rregullshme, 25 janë auditime përputhshmërie, 14 janë auditime financiare, 15 janë auditime performance, 5 janë auditime të teknologjisë së informacionit, si dhe 5 të tjera janë auditime tematike.

Institucioni ka arritur të konsolidojë një nivel dysHEME auditimesh për të siguruar mbulueshmërinë e duhur me auditim në fushat kryesore të shpenzimeve publike dhe gjenerimit të të ardhurave, prag në të cilin nuk ka rënë asnjë në 6 vjetët e fundit.

Nga auditimet e kryera në vitin 2017 KLSH-ja ka identifikuar mungesë përgjegjshmërie nga titullarët e institucioneve të çdo niveli, mosnjohje të kërkesave të ligjit të menaxhimit financiar, nivele të ulëta dhe inefficiencë të sistemeve të kontrollit të brendshëm, duke krijuar risqe për shpenzime jo në përputhje me kërkesat ligjore dhe efektivitet të ulët në shpenzimin e fondeve buxhetore.

KLSH-ja ka konstatuar se vijojnë praktikatat dhe vendimmarrjet institucionale me efekte negative në fondet publike, ku niveli i dëmeve dhe i shpenzimeve joefektive të konstatuara paraqitet si më poshtë:

- parregullsi dhe shkelje financiare në të ardhurat dhe shpenzimet e kryera, me dëm ekonomik në shumën totale prej 11,5 miliardë lekësh ose 85,8 milionë euro;

- shkelje të disiplinës financiare me ndikim negativ në performancën e fondeve publike të shpenzuara nga subjektet e audituara në shumën totale prej 99,05 miliardë lekësh, ose afërsisht 739,7 milionë euro, nga të cilat 92,7 miliardë lekë në fushën e të ardhurave dhe 6,3 miliardë lekë në fushën e shpenzimeve. Në total janë konstatuar shkelje në shumën 110,5 miliardë lekë ose afërsisht 825,6 milionë euro.

Dëmi i konstatuar është në trend rritës në vitet e fundit, pavarësisht përpjekjeve që bëjnë drejtuesit e institucioneve të ekzekutivit dhe agjencitë e tjera ligjzbatuese në vend. Indikator i cilësisë së auditimit, i cili është një tregues që

mat raportin e shpenzimeve të buxhetit të shtetit për kontrollin nga institucioni i KLSH-së me dëmin, që janë shpenzimet joefektive të zbuluara nga KLSH, kryesisht me dëmin për vitin 2017, është 31,9 lekë. Ndërsa po ta krahasojmë me periudhën 6-vjeçare (2012-2017), rezulton se për çdo 1 lek të shpenzuar nga institucioni i KLSH-së është kërkuar të zhdëmtohen 108,7 lekë, ose 5 herë më shumë, nga 21,1 lekë, që ishte ky tregues në periudhën 2002-2011.

Edhe gjatë vitit 2017, KLSH-ja ka adresuar rekomandime për institucionet publike të audituara, struktura e të cilave ka ruajtur të njëjtën tipologji sikurse në vitet e kaluara.

Janë dhënë 3521 masa për përmirësime ligjore, masa organizative, masa administrative dhe masa disiplinore për periudhën janar-dhjetor 2017, nga të cilat janë pranuar afërsisht 60% e masave të rekomanduara. Ky numër vijon të plotësohet, pasi në 6-mujorin e dytë të vitit 2017 ne vazhdojmë auditimet për zbatimin e rekomandimeve tona, duke respektuar kërkesat e ligjit, sipas të cilit ne jemi të detyruar t'i presim subjektet 6 muaj për zbatimin e rekomandimeve tona.

Puna audituese është përqendruar kryesisht në fushat për të cilat Kontrolli i Lartë i Shtetit ka vlerësuar një nivel të lartë risku dhe ku sistemet e kontrollit janë të niveleve që nuk mund të garantojnë dhe japin siguri për një aktivitet në përputhje me kërkesat e kuadrit të menaxhimit financiar dhe të kontrollit. Edhe në të ardhmen puna jonë audituese do të vazhdojë të mbështetet në punën e audituesve të brendshëm.

Standardet e Auditimit dhe Menaxhimit të Cilësisë

Auditimi financiar me dhënien e opinionit për pasqyrat financiare, megjithëse përbën një nga aktivitetet audituese tradicionale, për shkak të niveleve të deformuara ndër vite të raportimit financiar në sektorin publik (pas viteve '90-të), për praktikën e KLSH-së mbetet ende një lloj relativisht i ri auditimi, i cili kërkon punë dhe mbështetje tërësisht në standardet e auditimit.

Për vitin 2017, KLSH-ja ka dhënë opinion për pasqyrat financiare të 14 njësive publike dhe po progresojmë nga viti në vit në këtë fushë. Kemi qenë të kushtëzuar nga mungesa e pasqyrave financiare të konsoliduara të shtetit,

mungesa e pasqyrave të konsoliduara në nivel qendror dhe në nivelet e tjera.

Korniza e matjes së performancës kërkon adoptimin e manualit të auditimit financiar dhe të përputhshmërisë, në përputhje me standardet ISSAI 200 dhe ISSAI 400. Në lidhje me këtë dimension, KLSH-ja i përmbush pjesërisht, 2-3 nga 4 kërkesat e përcaktuara. Që në vitin 2012 i kemi përkthyer këto standarde, i kemi përshtatur dhe po i përdorim në punën tonë në zbatim të një marrëveshjeje që kemi me IDI-in për implementimin e standardeve ndërkombëtare të auditimit.

Për auditimet financiare, KLSH-ja përmbushi plotësisht 20 nga 21 kërkesat e këtij dimensionit vlerësimi.

Për auditimet e përputhshmërisë, KLSH-ja përmbushi plotësisht 11 nga 18 kërkesat e këtij dimensionit vlerësimi.

Lidhur me auditimet e performancës, që është një auditim i ri, KLSH-ja e ka strukturuar aktivitetin auditues në 5 fusha të konsideruara me risk të lartë për buxhetin e shtetit dhe konkretisht në:

1. Projektet infrastrukture
2. Projektet mjedisore dhe energjetike
3. Projektet social-ekonomike
4. Projektet social-kulturore
5. Reformat qeveritare

Ky auditim është rritur ndjeshëm në KLSH. Ne jemi të kënaqur me ritmet dhe tashmë ky auditim është vlerësuar ndjeshëm edhe nga simotrat tona në 2-3 vjetët e fundit.

Nga temat e trajtuara për vitin 2017, mund të përmend telegrafisht: sigurinë ushqimore, zhvillimin e turizmit, ruajtjen e ekosistemit të liqenit të Prespës, performancën e DAP-it, prokurimet publike, detyrimet tatimore të prapambetura, grantet në Agjencinë e Zhvillimit të Bujqësisë, performancën e borxhit publik, kostimin e shërbimeve spitalore, unifikimin e pikave doganore me Kosovën, përmirësimin e sistemit të vlerësimit doganor etj.

Tashmë kemi krijuar praktikën e mirë që ia përcjellim këto auditime Kuvendit të Shqipërisë, Komisionit tonë bazë për Ekonominë dhe komisioneve të tjera parlamentare.

K Kontrolli i Cilësisë

Në bazë të standardit ISSAI 40 për kontrollin e cilësisë, ne i përmbushim këto kritere për arsye se ushtrojmë kontroll cilësie të

**ftohet** në masën 30% të dosjeve. Nga 156 auditime, është realizuar rikontrolli për 46 dosje, duke përfshirë të gjithë ciklin auditues. Kjo punë reflekton një përmirësim të dukshëm, referuar kornizës rregullatore të procesit auditues, ku rreth 27% e dosjeve vlerësohen shumë të mira, mbi 60% e tyre vlerësohen të mira dhe vetëm 13% e dosjeve të auditimit janë vlerësuar mjaftueshëm.

Fusha e katërt “Menaxhimi financiar, asetet dhe strukturat mbështetëse”

Në zbatim të ISSAI-t 20, vlerësimi i kësaj fushe tregoi se KLSH-ja ka një menaxhim organizativ të përshtatshëm dhe struktura mbështetëse, që sigurojnë një qeverisje të mirë të institucionit.

Gjatë vitit 2017 u realizua ngritja e infrastrukturës së IT-së në ambientin e godinës së re falë mbështetjes që na dha Kuvendi i Shqipërisë, Komisioni i Ekonomisë dhe qeveria shqiptare, si dhe investimi në krijimin e një sistemi informacioni për menaxhimin dhe mbështetjen e proceseve të auditimit në KLSH. Ky investim realizoi një sistem elektronik për administrimin e punës audituese në KLSH nëpërmjet një platforme *software* të integruar dhe me proces pune (*workflow*) të automatizuar në përputhje me manualët dhe me rregulloren në fuqi në lidhje me disponueshmërinë, integritetin dhe konfidencialitetin e sistemit. Këtë sistem ne e përmirësojmë dhe e plotësojmë nga muaji në muaj në kuadër të punës sonë audituese.

Fusha e pestë “Burimet njerëzore dhe trajnimi”

Ky aspekt i aktivitetit është vlerësuar bazuar në ISSAI-40, si dhe në udhëzuesin e Komitetit të Ndërtimit të Kapaciteteve të INTOSAI-t për menaxhimin e burimeve njerëzore, kuadrin institucional të ndërtimit të kapaciteteve. Aspektet dimensionale të kërkuara lidhen me funksionin e burimeve njerëzore, strategjinë e burimeve njerëzore, rekrutimin e burimeve njerëzore, shpërblimin, promovimin dhe mirëqënien e stafit etj.

Në KLSH kemi prej vitesh një dokument të politikave të burimeve njerëzore, të cilin e apdejtua në bashkëpunim me ekspertët e NIK-ut polak. Pavarësisht mbështetjes që na është dhënë nga Kuvendi i Shqipërisë duke shtuar çdo vit nga 5 auditues, ne si institucion kemi ende

nevojë për shtimin e numrit të auditimeve, duke e krahasuar me punën tonë si institucion.

Profesionet kryesore të stafit auditues janë financiarë dhe juristë. Për vetë natyrën dhe kompleksitetin e punës, kërkesat për këto profesione rriten, ashtu si edhe për inxhinierë të IT-së apo specialistë të diplomuar në ekonomi informatike. Kemi një tregues shumë sinjektiv për sa i përket barazisë gjinore. Për vitin 2017, raporti femra - meshkuj është 40 % me 60%, nga 33 % me 67% që ishte në vitin 2011.

Kemi ulje të moshës mesatare në KLSH, në fund të vitit 2017 ishte 42,9 vjeç, nga 50 vjeç që ka qenë në vitin 2011. Ky progresion i natyrshëm na bën të krijojmë një kontingjent audituesish edhe për vitet e ardhshme (2020-2025), kohë kur Shqipëria do të jetë në BE.

KLSH-ja ka zbatuar politika efektive të menaxhimit dhe rekrutimit të burimeve njerëzore, bazuar në 3 parime bazë:

- i) vlerësimi i profesionalizmit
- ii) i transparencës
- iii) konkurrimi i hapur dhe mundësia e

pjesëmarrjes për të gjithë të interesuarit

Gjatë vitit 2017 janë rekrutuar në KLSH 22 auditues, nga të cilët 1 drejtues me titullin “profesor doktor”, 2 drejtues me diplomë ndërkombëtare në Kontabilitet dhe Auditim dhe 1 auditues me titullin Doktor i Shkencave.

Në 6 vjetët e fundit (2012-2017) janë rekrutuar në KLSH dhe vazhdojnë të punojnë 8 drejtues ose auditues, të cilët kanë titullin “profesor”, “profesor i asociuar”, ose “doktor i shkencave”; 19 drejtues dhe auditues që kanë një diplomë të dytë, nga të cilët 14 në Drejtësi dhe 5 në Financë; 5 drejtues dhe auditues kanë diplomë/certifikatë ndërkombëtare në Kontabilitet dhe Auditim (CIPFA) dhe certifikatë ndërkombëtare në auditim (CPA).

Sistemi i zhvillimit profesional reflekton efektivitetin e politikave të rritjes së kapaciteteve profesionale në KLSH në vite dhe është një tregues i konsoliduar.

Në komunitetin EUROSAT, mbas Estonisë, jemi të dytët për faktin se zhvillojmë mbi 25 ditë trajnimi në vit. Ky tregues nga 2-3 ditë, që ka qenë në periudhën 2010-2011, tashmë është 14-fishuar.

Në fund të vitit 2017 kishim 28,8 ditë trajnimi të realizuara në institucionet tona homologe, jashtë dhe brenda vendit, me personel

akademik, në bashkëpunim dhe të zhvilluara në ambientet akademike dhe organizatat profesionale të fushës, që ne i kemi partnere.

Komunikimi dhe menaxhimi i palëve të interesit

Në vitin 2017 KLSH-ja ka hartuar dhe miratuar Strategjinë e re të Komunikimit të KLSH-së për periudhën 2017-2019, e cila është vlerësuar me 3 nga 4 pikë të mundshme. Po përpiqemi të përmirësohemi vazhdimisht.

Një arritje të veçantë (për këtë falënderoj Kuvendin dhe veçanërisht Kryetarin e tij) kemi në komunikimin me parlamentin, i cili këtë vit është rritur ndjeshëm jo vetëm në sasi, por edhe në cilësi. Edhe sot, pavarësisht vëmendjes suaj apo mungesave, ky fakt flet shumë. E rëndësishme është që Kryetari i KLSH-së të flasë në Kuvend. Dëgjojnë ata që marrin pjesë, por dëgjojnë edhe ata që nuk marrin pjesë. Këtu flitet për dëme ekonomike të zbuluara gjatë veprimtarisë sonë audituese, flitet për punën e 180 audituesve dhe nuk bëhet fjalë për performancën time si person, pasi nuk shquhem për performancë në shpejtësinë e të folurit.

Megjithatë, ne vlerësuam maksimalisht rezolutën e Kuvendit të tetorit 2016 dhe besoj se jemi i vetmi institucion që kemi përcjellë tek ju planin tonë të punës për zbatimin e kësaj rezolute dhe e realizuam këtë në harkun kohor të 2 vjetëve.

Në cilësinë e Kryetarit të KLSH-së dhe në emër të audituesve të KLSH-së vlerësoj maksimalisht mbështetjen që na ka dhënë Komisioni për Ekonominë dhe Financat, vlerësoj maksimalisht kryetarin e këtij komisioni, Erion Braçe, sekretarin e këtij komisioni, prof. dr. Anastas Angjeli, anëtarët e komisionit të PD-së, të LSI-së dhe të PS-së, veçanërisht anëtarin e komisionit, zotin Florjon Mima e të tjerë.

Më duhet të shpreh respektin dhe vlerësimin tim për të gjithë deputetët e Kuvendit të Shqipërisë, përfshi edhe Kryetarin e Kuvendit, pavarësisht kahjeve politike, për mbështetjen që i kanë dhënë KLSH-së.

Dimensioni i komunikimit të KLSH-së me medien është vlerësuar me 3 nga 4 pikë, duke identifikuar se duhet të realizohen më shumë konferenca për shtyp për raportin vjetor të institucionit dhe duke përfshirë, sipas rastit, raporte të tjera të rëndësishme dhe raporte të

auditimit të performancës në përmbushje të kërkesave të udhëzimit të INTOSAI-t: "Komunikimi dhe promovimi i vlerave dhe përfitimeve të SAI-ve".

I falënderoj të gjitha mediet pa asnjë paragjykim, sepse na kanë dhënë mbështetje maksimale dhe na kanë ndihmuar në punën tonë. Në fund të vitit 2017, institucioni ynë ka qenë i pranishëm me rreth 100 kronika televizive më shumë se në vitin 2016. Institucioni ynë është prezantuar në medien e shkruar me 840 artikuj, njoftime, editoriale dhe komente analitike, kundrejt pothuajse zero që ishte ky prezantim gjatë viteve 2010-2011.

Kemi një veçori. Pothuajse çdo ditë audituesit e KLSH-së dalin me një shkrim në medien e shkruar, ku trajtojnë problematika të ndryshme të auditimeve. Kjo është një praktikë, e cila po rezulton shumë e eficiente. Mendojmë të vazhdojmë në të ardhmen edhe në rrjetet sociale, por gjithmonë, duke ruajtur kompleksitetin e brishtë të marrëdhënieve tona me subjektet e audituara, duke mos dashur në asnjë mënyrë të cenojmë cilindo subjekt që auditohet, punën dhe djersën e tyre. Jemi përpjekur të jemi të kujdesshëm. Ritheksoj këtu moton që kemi pasur dhe kemi në punën tonë: "Institucioni suprem i auditimit (KLSH) auditon zbatimin e politikave, por nuk bën politika". Kjo nuk është thënia ime, por është thënia e audituesit të Përgjithshëm të GAO-s amerikane, që është konkluzioni nr.1 i komunitetit të INTOSAI-t në botë.

Projekti i binjakëzimit IPA 2013 "Forcimi i kapaciteteve të auditimit të jashtëm", i financuar nga BE-ja, nisi të implementohej në KLSH në muajin mars të vitit 2016, u fitua në vitet 2012-2013 falë edhe mbështetjes të qeverisë së asaj kohe, të drejtuar nga profesor doktor Sali Berisha", vijoi të implementohej deri në fund të vitit 2017 dhe përfundoi me sukses, sipas vlerësimeve të EUROSAT-it, NIK-ut polak, SAIT-it kroat, si dhe të delegacionit të BE-së dhe DG Buxhet, pra partnerëve tanë jashtë.

Projekti ishte i ndarë në tre komponentë:

- përmirësimi i kornizës ligjore për auditim;
- zhvillimi i metodologjive të auditimit dhe kapaciteteve të raportimit;
- forcimi i kapaciteteve institucionale dhe përmirësimi i impaktit të rezultateve të auditimit

Në mënyrë që të identifikonim qartë objektivat tanë strategjike përpara hartimit të strategjisë 2018-2022, ne aplikuar analizën SWOT në institucion, në të cilën përcaktuar fuqitë dhe dobësitë tona, kërcënimet, oportunitetet e ndryshme dhe listuar faktorët pro dhe kundër aktivitetit tonë auditues. Faktorët janë të lidhur me rritjen e kapaciteteve audituese, organizimin më të mirë të punës, raportet më të mira me Kuvendin, agjentë të të cilit ne konsiderohemi, për vendosjen e besimit të qytetarëve. Jo më kot motoja e zgjedhur nga ne është: “KLSH-ja është shërbëtori i qytetarit”.

Në reflektim të risqeve dhe analizës që ne zhvilluam, si dhe mbështetur në strategjitë e zhvillimit të INTOSAI-t dhe EUROSAT-t, pas vitit 2018 objektivat tanë prioritarë në strategjinë 2018-2022 u formuluan në tri shtylla kryesore:

1. Rritja e impaktit të punës audituese me fokus te 6E-ja. Pra, tashmë ne kalojmë nga koncepti 3E (eficiencë, efektivitet, ekonomikitet), të cilin e zhvilluam pas vitit 2012, në konceptin 6E ku tre “E-ve” të para u shtohet edhe energji, etikë dhe ambient (environment).

2. Optimizimi i kapaciteteve profesionale, aftësive audituese, procedurave të punës, logjistikës dhe funksioneve të tjera mbështetëse.

3. Vazhdim i përmirësimit të kanaleve të komunikimit dhe bashkëpunimit me partnerët dhe palët e interesit.

Sigurisht, brumi i aktivitetit tonë duhet të vijë nga objektivi i parë, që është objektivi madhor. Por, sikurse brumi nuk mund të bëhet bukë e mirë nëse mielli është jociësor apo furra nuk funksionon, dy objektivat e tjerë janë po aq të rëndësishëm për të rezultuar të suksesshëm.

Vetë objektivi 1 zërthehet në një sërë objektivash, secili i rëndësishëm dhe bashkarisht shterues. Në ta adresohen të gjitha problematikat e konstatuara dhe të pakorrekta plotësisht në planin strategjik 2013-2017, sikurse edhe sfidat e reja që ofron e ardhmja, duke dëshmuar kështu se plani i ri është, në fakt, një vazhdimësi e natyrshme e përditësuar e planit të mëparshëm strategjik.

E njëjta gjë ndodh edhe me objektivat e tjerë, secili i zërthyer dhe i detajuar në disa fusha, me dimensionet dhe parametrat përkatës të arritjes dhe kontrollit.

Kujtoj se për strategjinë 2018-2022 ne kemi pasur një bashkëpunim të ngushtë me

Komisionin e Ekonomisë. E kemi përcjellë të deputetët e Kuvendit, kemi marrë mendimet tuaja dhe pastaj kemi reflektuar strategjinë përfundimtare.

Në formulimin e këtyre objektivave motoja dhe qëllimi parësor është: “Kontrolli i Lartë i Shtetit, shërbëtori i qytetarit”. Kjo është vënë në respekt të standardeve ndërkombëtare të auditimit, në respekt të pritshmërisë që qytetarëve shqiptarë, por edhe në respekt të filozofisë së Mithat Frashrit, sipas të cilit institucionet dhe drejtuesit duhet të jenë shërbëtarë të qytetarëve. Në këtë strategji, KLSH-ja është e angazhuar maksimalisht edhe për plotësimin e objektivave të OKB-së në axhendën e saj të vitit 2030 të zhvillimit të qëndrueshëm.

Të nderuar deputetë,

I nderuar zoti Kryetar,

Në tërësi, zbatimi i kornizës të matjes së performancës së institucionit nga pikëpamja metodike, e krahasueshme me atë të partnerëve tanë të komunitetit të INTOSAI-t dhe EUROSAT-t, na inkurajon për t’u ballafaquar me sfidat e së ardhmes, si dhe përcakton aspektet që kërkojnë përmirësim të mëtejshëm, sipas standardeve të INTOSAI-t dhe praktikave më të mira ndërkombëtare.

Puna për rritjen e impaktit të veprimtarisë audituese për një qeverisje më të mirë dhe eficiente të pasurisë publike, kërkon zhvillimin shumëdimensional të institucionit. Për këtë ne jemi të ndërgjegjshëm. Vetëm nëpërmjet një partneriteti aktiv me ju, të zgjedhurit e popullit, me ekzekutivin, me Presidentin, me opozitën, me shoqërinë civile, me partnerët ndërkombëtarë dhe me median do të arrijmë të jemi rezultativë dhe të suksesshëm ndaj sfidave të zhvillimit të qëndrueshëm dhe proceseve të integritetit evropian, të cilat i kemi të përbashkëta.

Ju faleminderit!

*(Drejtimitin e seancës e merr zonja Hysi)*

**Vasilika Hysi** – Faleminderit, zoti Leskaj!

Ka pyetje nga kolegët dhe koleget deputete?

Po, zoti Mediu.

**Fatmir Mediu** – Faleminderit, zonja drejtuese e seancës!

Së pari, dua të vlerësoj raportimin dhe punën e institucionit të Kontrollit të Lartë të Shtetit dhe në veçanti të kryetarit të tij.

Kam dy pyetje: njëra ka të bëjë me rekomandimet që shtron parlamenti përballë jush, konkretisht rekomandimin nr. 2, që thotë: “KLSH -ja duhet të vijojë të thellojë përpjekjet për forcimin e pavarësisë së institucionit për të siguruar auditime të paanshme dhe objektive”. Pra, forcimi i pavarësisë dhe auditime të paanshme. Përderisa parlamenti ka arritur në këtë konkluzion, zoti kryetar, ka ndonjë vlerësim nga ana juaj që auditimet që ju bëni janë të njëanshme dhe të pavarura nga pikëpamja politike?

E dyta, raportet e Kontrollit të Lartë të Shtetit të çdo viti tregojnë abuzime pa fund me fondet publike. Pra, nuk kemi rënie të abuzimeve me fondet publike, por rritje. Në vlerësimin tuaj, si kryetar i Kontrollit të Lartë të Shtetit çfarë nuk funksionon në përgjigjen që duhet të japin institucionet që marrin rekomandimet e Kontrollit të Lartë të Shtetit, si ministritë përkatëse, qeveria, por edhe pjesa tjetër, që ka të bëjë me hetimin dhe vlerësimin përfundimtar në gjykatë?

Faleminderit!

**Vasilika Hysi** – Fjalën e ka zoti Leskaj.

**Bujar Leskaj** – Ju nuk të jepni asnjë minutë kohë për t’u menduar.

Rezolutën e Kuvendit të tetorit 2016, i nderuar zoti deputet, e kemi vlerësuar maksimalisht. Në këndvështrimin tonë, si Kontroll i Lartë i Shtetit, ajo është rezolutë shumë pozitive, e cila vlerëson punën tonë, por natyrisht shton dhe arritjet. Në këtë kontekst, për një formulim dhe adresim profesional përdoret shprehja: “Të rriten përpjekjet për auditime të paanshme dhe auditime profesionale”. Të paktën në këto vite që unë drejtoj Kontrollin e Lartë të Shtetit nuk ka pasur auditime të anshme, por si te rezoluta, ashtu edhe te Komisioni i Ekonomisë nuk ka qenë ky qëllimi. Gjithmonë jepen rekomandime, pasi institucioni suprem i auditimit riskohet nga kjo. Në çdo moment ne jemi midis Shilës dhe Karibdës, prandaj ky rekomandim është në këtë kontekst. Ne e kemi diskutuar këtë me hartuesit, por edhe në Komisionin e Ekonomisë dhe kemi gjetur mirëkuptim të plotë.

Rezolutën e Kuvendit të tetorit 2016 ne e kemi konsideruar një nga dokumentet më të rëndësishme në punën tonë. Kemi hartuar një plan zbatimi të rezolutës dhe kemi raportuar në

Kuvendin e Shqipërisë se si i kemi plotësuar kërkesat e kësaj rezolute.

Dëmet rriten, çfarë nuk funksionon?! Rekomandimi kryesor në progresraportet e BE-së është që të rriten përpjekjet për zbatimin e rekomandimeve të institucionit suprem të auditimit, pra të Kontrollit të Lartë të Shtetit, dhe të rriten përpjekjet për mbështetjen e institucioneve supreme të auditimit. Janë dy rezoluta të Organizatës së Kombeve të Bashkuara të dhjetorit 2011 dhe të dhjetorit 2013, që e kërkojnë këtë gjë. Unë mendoj se ne duhet të rrisim bashkëpunimin. Ne po e bëjmë punën tonë, natyrisht duhet të bëjmë më shumë, por duhet të rritet edhe trysia nga Kuvendi për zbatimin e rekomandimeve të KLSH-së.

Vendimi i fundit, që ka marrë Kuvendi i Shqipërisë për krijimin e mekanizmit të monitorimit të zbatimit të rekomandimeve të institucioneve të pavarura, ku zbatimi i rekomandimeve të KLSH-së zë vendin kryesor, unë gjykoj se është pozitiv, do të jetë pozitiv dhe do të sjellë fryte në të ardhmen.

**Vasilika Hysi** – Faleminderit, zoti Leskaj!

Fjalën e ka kërkuar deputeti Tritan Shehu.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Po, doktor, por fjalën e ka kërkuar zoti Tritan, i cili ka pyetje për të bërë.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Fjalën e ka zoti Berisha.

**Sali Berisha** – Zoti kryetar i Kontrollit të Lartë të Shtetit, unë kam një pyetje konkrete.

U ke deklaruar shqiptarëve, me dokumente origjinale shtetërore, të firmosura dhe të vulosura nga kjo maxhorancë, se këta ... Çdo epitete mund t’u vendosësh këtyre që janë mbrapa, me në krye atë kryehajdutin aty.

A iu drejtuar në fjalën tuaj: “O të poshtëruar hajdutë që u keni vjedhur 1,2 miliardë euro qytetarëve më të varfër të Europës, apo jo?!” Unë e kuptoj, por ka diçka, po shkoje te Mithat Frashëri, shkon tek e vërteta, dhe ajo e vërtetë do të të detyronte ty t’u drejtoheshe vetëm në këtë mënyrë atyre që u kanë grabitur shqiptarëve 1,2 miliardë euro në koncesione dhe tenderë. Kjo nuk është e dhëna ime apo e opozitës, por e institucionit qendror të llogarive të shtetit.

A e dini ju që këta kanë sjellë një ligj në parlament për Olsin dhe Geronin?! A e dini ju çfarë do të thotë ligji i Olsit dhe Geronit?! E dini,

apo jo?! Do të thotë të ulet me tri herë tatimi për lojërat e fatit, sepse Olsi dhe Geroni duhet 3-4-fishojnë ....

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Po, Pandeli! Më mirë mos fol, sepse ty të përzënë dhe të kthejnë përsëri. Lexoje ligjin! Pyeti specialistët se sa është përcaktuar fitimi në lojërat e fatit për lojtarët dhe sa është e përcaktuar për kompaninë. Kuptohet, në qoftë se gjeni raportin.

Çfarë bën ndryshimi i ligjit?! Zoti kryetar, ndryshimi i ligjit ul taksën për Olsin dhe Geronin, nga 80% të fitimit që kanë ata, tani nuk do t'u merret më 15%-i i 80%-it, por do t'u merret vetëm 20% e fitimit. Pra, ulet me katër herë taksa për lojërat e fatit. Ky është ligji.

Shkëlqim Cani, për të cilin kam diskonsideratë absolute, tregoi karakter dhe nuk pranoi ta firmoste një ligj të tillë, kurse "hajduti me çizme"...

**Vasilika Hysi** – Zoti Berisha, jemi në pjesën e pyetjeve, jo të diskutimeve. Nuk është e regjistruar për diskutime. Janë pyetje. Nëse ke pyetje, po.

**Sali Berisha** – Vasilika, ju, si shumicë, keni alergji ndaj të vërtetave.

**Vasilika Hysi** - Zoti Berisha, keni mundësi në 60 minutat e diskutimit për çështjet jashtë rendit të ditës të flisni për çdolloj çështjeje.

*(Deputeti Berisha nuk dëgjohet kur flet)*

Ju lutem, bëni pyetje direkte.

**Sali Berisha** – Kjo është pyetje.

Herë tjetër ki parasysh që t'u drejtohesh këtyre: "Hajdutë dhe kryehajdutë". Kjo është gjuha që kuptojnë këta.

**Vasilika Hysi** – Faleminderit!

Zoti Leskaj, nuk ka deputetë të tjerë të regjistruar për të bërë pyetje dhe as nuk është kërkuar debat, kështu që mbyllet diskutimi.

Faleminderit, zoti Leskaj!

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Vetëm pyetje nuk bëtë, doktor.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Zoti Leskaj, nëse arritët ta kuptoni pyetjen brenda diskutimit, ju lutem përgjigjuni.

**Bujar Leskaj** – I nderuar dhe i dashur doktor, mendoj se Kontrolli i Lartë i Shtetit dhe unë e kemi bërë punën tonë audituese. Ne nuk mund t'i kalojmë ato vija që ligji nuk na i lejon.

Ne audituesit nuk bëjmë politika, por auditojmë zbatimin e politikave.

Në rast se unë, si kryetar i Kontrollit të Lartë të Shtetit, në punën time në këto vite do të kaloja në këtë fushë, riskoja pavarësinë e institucionit dhe profesionalizmin e institucionit. Mund të kisha fituar disa kredite më tepër për veten, por nuk do të ishte mirë për institucionin.

Për ne si Kontroll i Lartë i Shtetit, parësore janë interesat e qytetarëve shqiptarë, të taksapaguesve shqiptarë, interesat e ekonomisë kombëtare, ruajtja e pronës publike, pronës shtetërore, nëpërmjet auditimeve dhe rekomandimeve tona, por jo të kalojmë në politikë.

Ju falenderoj për të gjitha sugjerimet!

**Vasilika Hysi** – Faleminderit, zoti Leskaj!

Kuvendi i Shqipërisë do të miratojë një projektrezolutë.

Kalojmë në çështjen tjetër të rendit të ditës, projektligjin "Për një ndryshim dhe shtesë në ligjin nr. 8378, datë 22.07.1998 "Kodi Rrugor i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar", nismë e deputetit Pjerin Ndreu.

Sipas nenit 73, paragrafi 2, të Rregullores, a ka pyetje për projektligjin?

Nuk ka.

Zoti Ndreu, a dëshironi ta paraqitni nismën?

**Pjerin Ndreu** – E nderuar drejtuese e seancës,

Të nderuar kolegë,

Kjo nismë për të ndërhyrë me një ndryshim në nenin 127, pika 3, të Kodit Rrugor, është diktuar nga disa problematika të hasura në praktikën e përditshme për zbatimin e këtij Kodi, problematika, të cilat më së shumti prekin emigrantët shqiptarë, dhe të mos harrojmë se kemi 1 milion shqiptarë jashtë Shqipërisë, prekin shtetasit shqiptarë të Kosovës, shtetasit shqiptarë të Maqedonisë dhe turistët e huaj, që vijnë në Shqipëri për turizëm. Cilat janë problematikat?

Sot, me Kodin Rrugor aktual ka një sorollatje të tmerrshme, që vjen nga kontakti i parë me shërbimin e qarkullimit rrugor, bëhet fjalë për 10 shkelje, për të cilat Kodi parashikon heqje të lejes së drejtimit të automjetit. Pas marrjes së masës së heqjes së lejes është një kalvar i tmerrshëm që fillon me policinë, nga policia kalon në prefekturë, prefektura brenda 5 ditëve duhet të japë një masë dënimi nga 1 deri në 3 muaj, më pas, nga prefektura shkon prapë në polici, nga policia kalon në Ministrinë e

Jashtme, nga Ministria e Jashtme kalon në konsullatën e vendit ku banon personi. Në rastin më të mirë duhen 3 muaj për të marrë patentën, lejen e drejtimit të automjetit. Kemi hasur problematika të pazgjidhshme, që kanë sjellë pasoja të rënda në jetën, në punën dhe në shumë aspekte të ndryshme personave që janë penalizuar.

Çfarë ka ndodhur? Ka ndodhur që këta persona kanë ardhur, janë penalizuar dhe nuk kanë marrë dot as lejen e drejtimit. Mirëpo me këtë leje drejtimi ata janë të punësuar diku jashtë shtetit, kanë patentën, punojnë me kamionë, nxjerrin bukën e gojës dhe ne nuk kemi pasur mundësi t'ua japim patentën. Ka ndodhur që janë nisur për rrugë, kanë ngelur në rrugë me gratë dhe fëmijët e tyre dhe ne nuk kemi qenë në gjendje t'u kthejmë lejen e drejtimit të automjetit. Po marr si analogji se çfarë ndodh në Kosovë. Ne kur u marrim patentën shtetasve kosovarë na duhen 3 muaj për t'ua kthyer, ndërsa kur ne shkojmë në Kosovë mundemi të paguajmë gjobën dhe e marrim lejen e drejtimit të automjetit menjëherë.

Pra, në këto situata, kam propozuar të gjejmë një rrugë alternative: drejtuesi i automjetit që penalizohet, nëse dëshiron, mundet që me dyfishin e penalitetit, në rastin konkret të gjobës, ta marrë patentën në vend, pa hyrë në kalvarin e tmerrshëm të sorollatjeve polici-prefekturë, prefekturë-polici, polici-Ministri e Jashtme.

Është e vetmja pikë e Kodit që ka hasur probleme edhe në komision: pse ne nuk ndërhyjmë në shumë problematika të Kodit? Kodi me të vërtetë ka shumë probleme, por është e vetmja problematikë që nuk ka zgjidhje dhe penalizon rëndë shtetasit shqiptarë, kryesisht emigrantët, por edhe shtetasit shqiptarë nga Kosova dhe Maqedonia.

Si deputet i qarkut të Lezhës kam kontakte të përditshme për këtë problematikë, sidomos nga shtetasit shqiptarë të Kosovës (në kryqëzimin e Milotit ndodhet vetëm një kalim për të ardhur në Shqipëri për pushime), të cilët penalizohen dhe ne nuk u japim dot zgjidhje për kthimin e patentës.

U bëj thirrje të gjithë deputetëve ta shohim këtë problem jo si një problem politik, por...

*(Ndërhyrje nga salla pa mikrofon)*

Ato i di ti, Doktor. Ato që i di ti, unë nuk i di...

*(Ndërhyrje nga salla pa mikrofon)*

Doktor, të lutem, unë merren me gjëra serioze, nuk merrem me gjëra...

Dakord!

Ti ke kohë për gjëra të tjera, por për mua kjo është diçka mjaft serioze, sepse gjërat që nuk janë serioze janë për Facebook, nuk janë për këtu, në parlament...

*(Ndërhyrje nga salla pa mikrofon)*

Si një detyrim që kemi ndaj shtetasve shqiptarë që ndodhen jashtë shtetit, ndaj shtetasve shqiptarë që banojnë në Kosovë, për të cilët ju, unë, të gjithë kemi dashuri të madhe, duhet t'i hapim rrugë një zgjidhjeje teknike. Ashtu siç ata na e japim patentën pas pagesës së gjobës, edhe ne duhet t'ua japim. Kjo vlen edhe për turistët e huaj që vijnë në Shqipëri.

Sot që jemi duke folur ka deputetë të PD-së, të PS-së, të cilët interferojnë me ne për t'i marrë këto patenta dhe ne nuk jemi në gjendje ta zgjidhim këtë problem. Prandaj mendoj se ai duhet parë. Tentativa për të na futur në disa hulli të paqarta, ku disa interpretime politike absurde, si, për shembull, të thuash se me këtë masë do të mbushim buxhetin e shtetit, është skandaloze. Efekti në buxhetin e shtetit është i papërfillshëm, është zero, është një shumë parash mjaft qesharake. Këtu bëhet fjalë për një zgjidhje. Prandaj, ju bëj thirrje të bashkoheni dhe ta votoni këtë ndryshim, sepse krijon drejtpërsëdrejti lehtësi për emigrantët, për shtetasit shqiptarë të Kosovës, për shtetasit shqiptarë të Maqedonisë dhe për turistët e huaj.

Faleminderit!

**Vasilika Hysi** – Faleminderit, zoti Ndreu!

Për këtë projektligj janë regjistruar për të diskutuar nga Grupi Parlamentar i Partisë Socialiste deputetët: Taulant Balla, Elisa Spiropali, Xhemal Qefalia, Jurgis Çyrbja dhe Sadi Vorpsi. Nga Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike nuk ka deputetë të regjistruar. Nga Grupi Parlamentar i Lëvizjes Socialiste për Integrim janë regjistruar deputetët Luan Rama, Endrit Braimllari, Viktor Tushaj, Edmond Haxhinasto, Silva Cakaj dhe Kejdi Mehmetaj.

Meqenëse shumë shpejt do të jetë e pranishme për të përshëndetur seancën Presidentja e Kroacisë, do t'ju lutesha ta ndërpresim seancën për 2 minuta!

Faleminderit!

*(Rifillon seanca)*

*(Drejtimin e seancës e merr zoti Ruçi.)*

**Gramoz Ruçi** – Të nderuar deputetë,

Siç jeni në dijeni, sot Kuvendin e Republikës së Shqipërisë do ta përshëndesë Presidentja e Republikës së Kroacisë, prandaj e mirëpresim zonjën Presidente të zërë vend.

*(Duartrokitje në sallë)*

Shkëlqesia Juaj, zonja Presidente e Kroacisë, Kolinda Grabar-Kitaroviç,

Shkëlqesia Juaj, President i Shqipërisë, zoti Ilir Meta,

Të nderuar ambasadorë dhe përfaqësues të trupit diplomatik,

Të nderuara deputete dhe deputetë,

Zonja dhe zotërinj,

Kam kënaqësinë dhe privilegjin t'i uroj mirëseardhjen në Kuvendin e Republikës së Shqipërisë Shkëlqesisë së Saj, zonjës Kolinda Grabar-Kitaroviç, Presidente e Republikës së Kroacisë. Kroacia është një vend mik dhe partner i Shqipërisë në sfidat tona të përbashkëta për zhvillim, për mirëqenie, për demokraci, për paqe dhe stabilitet në rajon. Kroacia është një mbështetëse dhe aleate, model i suksesshëm për Shqipërinë dhe të gjithë shqiptarët e rajonit në përpjekjet për integrimin në Bashkimin Europian dhe bashkimin tonë me familjen europiane. Në këto vlerësime jam i bindur se shpreh mirënjohjen e përbashkët të të gjitha forcave politike dhe të deputetëve të Kuvendit të Shqipërisë, si dhe të gjithë qytetarëve shqiptarë.

E nderuar Presidente, vizita juaj është një rikonfirmim i marrëdhënieve dhe i bashkëpunimit të shkëlqyer midis dy vendeve dhe dy popujve tanë për të mirën e përbashkët të tyre, të popujve të rajonit dhe më gjerë.

Zonja dhe zotërinj, ftoj Presidenten e Kroacisë, zonjën Kolinda Grabar-Kitaroviç, për të përshëndetur Kuvendin e Shqipërisë!

**Kolinda Grabar-Kitaroviç** -

I nderuar President,

I nderuar Kryetar i parlamentit,

I nderuar Kryeministër,

Të nderuar deputetë dhe përfaqësues të qeverisë,

Të nderuar anëtarë të trupit diplomatik,

Shkëlqesitë tuaja,

Zonja dhe zotërinj,

Të dashur miq,

Së pari, më lejoni t'i shpreh mirënjohjen time parlamentit të Republikës së Shqipërisë, që më ka bërë këtë ftesë dhe më ka dhënë mundësinë për t'ju përshëndetur me rastin e vizitës sime shtetërore në Republikën e Shqipërisë.

Dy vendet tona janë të lidhura fizikisht me detin Adriatik, por, gjithashtu, me diçka më të fortë, e cila ka lehtësuar një miqësi të përhershme dhe të pandashme ndërmjet popujve të dy vendeve tona: Shqipëria ka qenë vendi ynë mik, kur miqtë ishin të paktë dhe më shumë të nevojshëm. Gjatë luftës dhe mbrojtjes sonë kundër agresioneve shumë shqiptarë u bënë pjesë e forcave të mbrojtjes kroate dhe luftuan për pavarësinë e Kroacisë. Ne, në fakt, ishim pjesë e së njëjtës ushtrie edhe para se të bëheshim pjesë e NATO-s në të njëjtën ditë në vitin 2009. Shumë shqiptarë sakrifikuan jetët e tyre për Kroacinë. Më besoni, Kroacia nuk harron!

Për shkak edhe të vetë formës si shqiponjë të territorit të Kroacisë dhe pozicionit të saj historik, si një vend ku takohen kulturat e ndryshme, kristianizmi dhe islami, si dhe traditat tona detare dhe kontinentale, Kroacia është një shembull i shkëlqyer i bashkëjetesës, i gjithëpërfshirjes dhe integritetit të kulturave dhe feve të ndryshme.

Shqiptarët janë tërësisht të integruar, janë qytetarë dhe anëtarë të respektuar të shoqërisë kroate. Ata, gjithashtu, janë të përkushtuar për të mbajtur gjallë të gjitha lidhjet sociale, kulturore dhe ekonomike të vendeve tona, duke dhënë kështu kontributin e tyre në përf forcimin e marrëdhënieve Kroaci-Shqipëri. Ata janë një shembull i mrekullueshëm si pakicat mund të bëhen një urë e rëndësishme për përfitimet e të dy kombeve. Mënyra si ata e duan dhe e respektojnë Kroacinë, duke qenë në të njëjtën kohë krenarë dhe shqiptarë patriotë, është një shembull i shkëlqyer i ndikimit pozitiv në marrëdhëniet e vendeve tona.

Në këtë lloj lidhjeje duhet të përmend edhe komunitetin arbanasi në Zadar, i cili ka ekzistuar atje që në shekullin XVIII. Një numër i madh argjendarësh dhe pasticerësh me origjinë shqiptarë jetojnë dhe punojnë pothuajse në të gjitha qytetet e Kroacisë, janë bashkëqytetarë tanë, me të cilët ne shoqërohemi në pjesën tonë më të gëzueshme të jetës sonë të përditshme, dhe

kjo është falë aftësive dhe profesioneve të tyre tradicionale. Në këtë mënyrë ata japin kontributin e tyre në ekonominë e vendeve dhe qyteteve tona si qytetarë të vlerësuar dhe përgjegjës.

2 vjet më parë u themelua në Zagreb shoqata e artistëve shqiptarë në Kroaci, e cila ka si qëllim promovimin e artistëve dhe projekteve, që përfaqësojnë kreativitetin e artistëve shqiptarë në Kroaci.

Dua të përmend, gjithashtu, Nënë Terezën, një shenjtoreshë katolike, një misionare me origjinë shqiptare, e cila themeloi “Misionarët e bamirësisë” dhe ka qenë aktive në 133 vende në të gjithë botën, përfshirë këtu edhe Kroacinë, të cilën që nga viti 1928 e ka vizituar disa herë. Ajo u ndikua shumë edhe nga prifti kroat Franjo Jambreković në Shkup. Në Indi ajo punoi, gjithashtu, me një tjetër prift kroat Ante Gabrij. Më 19 korrik të vitit 1990 qyteti i Zagrebit e deklaroi Nënë Terezën “Qytetare nderi” e Zagrebit.

Miqësia jonë, miqësia ndërmjet kroateve dhe shqiptarëve daton shumë herët, që në kohën kur Dalmacia dhe Shqipëria ishin të sunduara nga Republika e Venedikut.

Gjergj Kastriot Skënderbeu është një nga figurat historike më të njohura shqiptare, një komandant ushtarak, i cili ndaloi avancimin e perandorisë osmane dhe e lejoi Europën që të përfundojë ndërtimin e mureve të qyteteve të tyre për t’i rezistuar këtij sundimi, që ishte mjaft i përhapur në Kroaci dhe në të gjitha vendet tona fqinje. Këtë ne ia dedikojmë suksesit të tij.

Një nga themeluesit e albanologjisë ishte historiani kroat, shkencëtar, figurë politike dhe përkthyes, Milan Shuflai, i cili ia përkushtoi jetën e tij hulumtimit të historisë kroate dhe shqiptare. Shuflai botoi disa studime historike shkencore të popullit shqiptar, si një nga popujt më të vjetër të Ballkanit dhe Europës. Shuflai udhëtoi në Shqipëri në dhjetor të vitit 1929, me ftesën e mbretit shqiptar Ahmet Zogu, i cili kërkonte që të mbështeste kërkimet e Shuflait për historinë e Shqipërisë.

Një nga aspektet e të gjitha hulumtimeve të tij ka qenë çështja e marrëdhënieve kroato-shqiptare gjatë Mesjetës, një fushë e pa eksploruar deri atëherë. Në bazë të të gjitha provave që kishte, Milan Shuflai pranoi që kroatët kanë përshtatur mjaft elemente të

qytetërimit shqiptar dhe të paraardhësve të famshëm shqiptarë, të ilirëve. Sipas mendimit të tij, kroatët dhe shqiptarët kanë pasur marrëdhënie mjaft të mira gjatë të gjithë periudhës së historisë së Mesjetës dhe më vonë. Nuk ka pasur asnjëherë ndonjë dokument që dëshmon ndonjë konflikt ndërmjet tyre, kjo asnjëherë nuk ka qenë e dokumentuar.

Duke përdorur këto fakte historike ai e zgjeroi dhe forcoi më tej marrëdhënien ndërmjet dy popujve, kroat dhe shqiptar, një histori marrëdhëniesh që ka ekzistuar për më shumë se një mijë vjet.

Një tjetër lidhje historike është edhe historiani kroat i shekullit të XVIII dhe shkrimtari Andria Kaçiq Miosiq. Nëpërmjet punës së tij ai, gjithashtu, promovoi Gjergj Kastriot Skënderbeun, heroizmin dhe mbrojtjen e tij kundër të gjithë perandorisë Osmane.

Në këtë vit, që Shqipëria e ka deklaruar si vitin e Skënderbeut, duhet përmendur që Skënderbeu dhe djali i tij kanë marrë titullin e qytetarit të nderit të Republikës së Dubrovnikut për kontributin e tyre në luftën kundër perandorisë osmane dhe në forcimin e marrëdhënieve tregtare.

Në fillim të viteve ’90 ngritja e kanaleve diplomatike të komunikimeve ndërmjet Kroacisë dhe Shqipërisë nuk ka qenë një proces pa probleme. Kroacia ishte në luftën e saj për fitoren e pavarësisë dhe njohjen ndërkombëtare, por në të njëjtën kohë përpiqej të ndërtonte institucionet kryesore shtetërore të saj dhe forcat e saj të armatosura.

Shqipëria, gjithashtu, po përballej me sfida mjaft ekstreme në ngritjen e një demokracie dhe ekonomie tregu pas dekadash të tëra izolimi dhe diktature komuniste.

Hapja e ambasadës së Republikës së Kroacisë në Tiranë në mars të vitit 1994 është pa dyshim një ngjarje historike për marrëdhënie ndërmjet dy vendeve tona. Me këtë rast presidenti kroat Franjo Tudman vizitoi Tiranën dhe hapi këtë ambasadë. Zyrtarët më të lartë shqiptarë ishin pjesë e ceremonisë së hapjes së kësaj ambasade. Presidenti Tudman theksoi në fjalimin e tij se Kroacia dhe Shqipëria duhet të bëhen mbështetëse të fuqishme të regjimit të ri ndërkombëtar në Europën Juglindore duke iu referuar kështu të gjitha demokracive të cilat sapo kishin lindur pas rënies së komunizmit dhe

perdes së hekurt. Që nga ajo ditë shumë nga ëndrrat tona u bënë realitet dhe qëllimi ynë strategjik për të qenë anëtarë të NATO-s me të drejta të plota u arrit nga të dyja vendet në vitin 2009.

Tani Kroacia dhe Shqipëria marrin pjesë si aleate në misionet e paqes dhe operacionet në zonat e krizës, siç është Afganistani. Kroacia i jep një rëndësi mjaft të madhe stabilitetit, sigurisë dhe begatisë së Europës Juglindore dhe e mbështet fuqishëm perspektivën europiane në rajon.

Gjithashtu, Shqipëria është një partner mjaft i rëndësishëm jo vetëm strategjik, por edhe politik. Kjo gjë është pranuar dhe njohur edhe nga Bashkimi European. Kroacia e mbështet fuqishëm rrugën e Shqipërisë drejt integritimit në Bashkimin European dhe mirëpret të gjithë progresin e dukshëm që është bërë nga Shqipëria në përmbushjen e kriterëve të kërkuara për anëtarësimin në BE.

Sot, si një komb i ri, energjik dhe me njerëz të zellshëm, të angazhuar ndaj vlerave demokratike perëndimore, Shqipëria ka perspektiva të shkëlqyera. Është mjaft e rëndësishme të theksohen shembujt pozitiv dhe Bashkimi European duhet t'i vlerësojë ata për këtë gjë.

Do të doja t'ju përgëzoja edhe për vendimin e Këshillit, i cili njohu progresin e bërë nga Shqipëria dhe kjo i hap rrugën çeljes së negociatave në qershor të vitit 2019. Për këtë arsye në vitin që vjen është mjaft e rëndësishme të sigurohet një bashkim kombëtar për çështjet strategjike, me qëllim që të ruhet motivimi për reformat.

Në këtë kontekst duhen pranuar dhe njohur reformat që Shqipëria ka bërë deri sot, veçanërisht ato në fushën e gjyqësorit. Është mjaft e nevojshme të theksohet rëndësia e procesit të vetingut, i cili do të rrisë besimin tek institucionet gjyqësore, të cilat përbëjnë edhe bazën e pushtetit ligjor.

Si shtet anëtar, që sapo jemi bërë pjesë e Bashkimit European, ne jemi veçanërisht të kënaqur me faktin që presidenca bullgare dhe austriake i kanë vendosur çështjet e zgjerimit si pjesë kryesore të axhendës së tyre. Ne e shikojmë këtë si një zhvillim, i cili mirëpritet dhe konfirmon edhe një herë angazhimin e ripohuar për Europën Juglindore nga vetë institucionet e

Bashkimit European dhe shtetet anëtare të Bashkimit European.

Kroacia do të vazhdojë në të njëjtën rrugë dhe do ta përkushtojë të gjithë vëmendjen e saj drejt zgjerimit. Këto gjëra do të bëhen pjesë e prioritetëve të presidencës sonë. Ne do të investojmë përpjekje më të mëdha për të organizuar një samit tjetër ndërmjet Bashkimit European dhe Ballkanit Perëndimor. Kroacia do të vazhdojë të mbështesë procesin e integritetit të Bashkimit European të Shqipërisë duke i ofruar përvojën dhe njohuritë e saj, duke mbështetur ngritjen e kapaciteteve të institucioneve shqiptare, përfshirë këtu forcimin e kapaciteteve administrative dhe institucionale.

Gjithashtu, ne do të vazhdojmë të punojmë së bashku për një bashkëpunim edhe më të mirë në fushën e transportit. Është e pabesueshme që në shekullin XXI, të dy vendet tona, duke mbajtur parasysh potencialin e jashtëzakonshëm të detit Adriatik, të kenë ende nivelin e lidhjeve detare të shekullit XIX. Kjo është pa dyshim një pengesë serioze për bashkëpunimin tonë.

Sa i përket bashkëpunimit ekonomik, ne duhet të forcojmë fushën e mbrojtjes së mjedisit. Ndërsa ndërtimi i gazsjellësit Jon-Adriatik mbetet një prioritet për të dyja vendet.

Si një komb, i cili ka një bukuri të shkëlqyer, ka një turizëm mjaft të madh dhe potencial të mirë bujqësor, si edhe duke pasur parasysh pozitën e saj gjeostrategjike, Shqipëria do të vazhdojë të luajë një rol të rëndësishëm në Europën Juglindore.

Për këtë arsye Kroacia kërkon të forcojë më tej marrëdhëniet strategjike me Shqipërinë, me qëllim që të përmirësojë edhe bashkëpunimin ekonomik.

Kroacia dhe Shqipëria mund të bëjnë shumë punë së bashku.

Do të doja t'ju uroja gjithë të mirat!

Miqësia kroate shqiptare qoftë sa më e gjatë!

**Gramoz Ruçi** – E nderuara zonja Presidente, ju faleminderit për fjalët!

Ju faleminderit për mesazhet drejtuar Kuvendit dhe gjithë qytetarëve të Republikës së Shqipërisë!

Këto mesazhe burojnë nga lidhjet e fuqishme historike dhe miqësia tradicionale midis dy popujve tanë, burojnë nga vlerat e përbashkëta që kemi kultivuar në shekuj,

burojnë nga bashkëjetesa e shkëlqyer e komunitetit shqiptar në Kroaci gjatë shekujve deri në ditët tona, burojnë nga përpjekjet tona të përbashkëta për t'u integruar në NATO dhe në Bashkimin Europian, burojnë nga sfidat tona të përbashkëta për mirëqenie për demokraci dhe për stabilitet në rajon dhe më gjerë.

Edhe një herë shumë faleminderit!

Zonja dhe zotërinj deputetë, më lejoni të shoqëroj zonjën Presidente dhe të vazhdojmë seancën.

Zonja Hysi mund të marrë drejtimin e seancës.

**Vasilika Hysi** - Të nderuar kolegë, vazhdojmë seancën plenare.

Fillojmë diskutimet për projektligjin “Për një ndryshim dhe shtesë në ligjin nr.8378, datë 22.07.1998 “Kodi Rrugor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar”.

Fjalën e ka deputeti Luan Rama.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

**Luan Rama** – Faleminderit, zonja Hysi!

Ju lutem, për efekt të administrimit të kohës, meqenëse diskutimi im është pak më shumë se 10 minuta, do të marr edhe kohën në dispozicion të deputetit Endrit Braimllari.

**Vasilika Hysi** – Koha juaj është 20 minuta në dispozicion.

**Luan Rama**- Zonja drejtuese e seancës,

**Luan Rama** – Kolegë deputetë,

Një abstragim për të mos u marrë drejtpërdrejt me çështjen, por mbi bazën e mundësisë që krijon procedura, do të bëj një vlerësim pak më romantik sesa herët e tjera.

Disa syresh i kam parë shumë vite më parë, ndonjë edhe e kam njohur, por, pavarësisht faktit në i kam njohur apo jo, të gjithë kishin diçka të ngjashme, diçka përbashkuese dhe po aq identifikuese në raport me të tjerët, kishin Bllokun, prej edhe nga morën nofkën identifikuese “bllokmenë”, një kompozitë gjysmë shqip, e gjysmë anglisht.

-Si nuk e kuptuan, dreqi ta marrë, që rrokullisja drejt theqafjes do t'i merrte edhe ata përpara, me gjithë “Bllokun” e tyre, e të paktën të mos ishin bërë pengesë?!- pyesnim shpesh njëri-tjetrin ne të “Zërit të popullit”, në atë dhjetorin e fundit të regjimit komunist të 1990-ës, pa marrë përgjigje prej askujt, sepse, në fakt, nuk kishte mbetur më askush!

Të gjithë kishin ikur, kishin ikur bashkë me “Bllokun” e tyre e ishin fshehur! Kishim mbetur vetëm ne, gazetarët e “Zërit të popullit”, pikëlidhja e vetme mes udhëheqjes, që nuk ishte, dhe mijëra të tjerëve në bazë, komunistëve intelektualë, punëtorëve, kooperativistëve, veteranëve, pensionistëve etj.

Nuk qe e lehtë! Ishte shumë e vështirë, madje shumë e vështirë 27 vjet më parë të zgjidhje të ishe socialist, ngjante pothuaj si një herezi! Ishte njësoj si të vetëzgjidhje linçimin e të pranoje ferrin, të pranoje barrën e mëkatit, që nuk e kishte kryer!

Të dilje si socialist rrugëve të Tiranës, pa folur për Shkodrën, Tropojën, Laçin, qoftë edhe Durrësin, Elbasanin e gjetiu, duhej të merrje parasysh që do të kaloje nëpër një kalvar fyerjesh, sharjesh, kërcënimesh e kanosjesh, për të cilat, po t'u flasësh sot atyre që kanë lindur në ato vite, mund të të marrin për të marrë! Por kështu ka qenë e kështu ka ngjarë! Ndër ne, në këtë sallë të Kuvendit ka ende dëshmitarë të atyre kohëve, sharës e të sharë, kanosës e të kanosur, dhunues e të dhunuar!

Lëvizja e dhjetorit të vitit 1990, duke rrëzuar nga pushteti Partinë e Punës, mbylli edhe epokën e saj dhe i çeli udhë ndryshimit të sistemeve! Partia Demokratike erdhi në pushtet. Partia e Punës, e mbetur pa udhëheqje, identifikohet me bllokmenët byroistë, paçka se edhe ata e kishin braktisur partinë së cilës i qenë bërë udhëmbyllës!

Ata që kishin vdekur, i nxorën nga varret, ndërsa të mbeturit gjallë, i përzunë nga Blloku e më pas edhe i burgosën!

Ndërsa Blloku iu kthye qytetit dhe qytetarët mund të shkelnin në të, bllokmenët, jo vetëm etërit, por të gjithë, edhe fëmijët e tyre, djemtë, vajzat, nusët, dhëndurët, nipër e mbesa e gjithë ç'qenë, u gjendën në udhëkryq e mes dy zjarresh: nga njëra anë, e djathta, që i urrente dhe i fajësonte për çdo gjë, nga ana tjetër, vetë partia e tyre, të cilën e kishin braktisur dhe e kishin lënë nën peshën e akuzave. Nën refrenin “komunistët në litar”, e gjente të keqen po tek ata, tek bllokmenët!

Gjithsesi, gjithçka duhej bërë! Mbi të gjitha duhej shpëtuar vendi, nuk duhej lënë të shkonte në kaos dhe anarshi!

Dukej mision i pamundur, por ia dolëm. Ia dolëm të fitojmë sfidën e kohës me të

shkuarën dhe të sfidonim të ardhmen! Partia Socialiste lindi si shpresë dhe shumë shpejt u bë alternativë qytetare e një kohe tjetër, e kohës në liri!

Por sot nuk dua të merrem me historinë e lindjes së Partisë Socialiste. Gjetiu e kam fjalën! Më konkretisht, dua të merrem pak me Bllokun, jo si kastën e udhëheqjes së Partisë së Punës, as me Bllokun si territor apo si hapësirë publike në qytetin tim mbushur me kontraste, në qytetin tim, të cilit qeveria do që t'i prishë teatrin e historisë qytetare, pasi i ka prishur më parë sheshin "Skënderbej" e bulevardin që dikur "ngacmonte" kronikanët e huaj të shpreheshin për të "Bulevardi pa qytet"! Jo, sot do të flas për "Bllokun institucion", për Bllokun si fenomen psikosocial e politiko-qeverisës.

Gjatë gjithë viteve në opozitën e parë të Partisë Socialiste, askush, asnjë i vetëm prej ish-udhëheqësve a të afërmeve të tyre nuk shkeli as edhe një herë të vetme në zyrrat e "Zërit të popullit" për të na parë si ishim e ku punonim, apo qoftë edhe për të na thënë një fjalë të vetme, si shenjë solidariteti në atë kohë terrori, ku edhe ne gazetarët e "Zërit të popullit", si të gjithë socialistët e thjeshtë, identifikoheshim padrejtësisht me ta, shaheshim për ta, urreheshim për ta, burgoseshim për ta!

Nuk u panë as në Partinë Socialiste, qoftë për t'u dukur një herë të vetme në oborrin e saj, se për komisionerë numërues në qendrat e votimit as që mund të mendohej! Ikën të gjithë, u fshehën e u zhdukën! Si minjtë kur ndiejnë tërmetin! U zhdukën dje, për t'u ringjallur sot e për të na u shfaqur si hibridë, si minjtë e Dino Buxatit në "Familjen që e gllabëruan minjtë".

"Një verë të largët (*tregon ai*) shumë kohë para luftës – ishte hera e dytë që shkoja si mik në shtëpinë e Koriove – më solli në mendje këtë skenë: isha ngjitur në dhomën e fundit të katit të dytë, ajo me dritaret nga oborri, e po shtrihesha të flija.

Dëgjova papritur një zhurmë të vogël, një gërvishtje në fund të derës. Shkova ta hap. Një miush i vogël shkau mes këmbëve të mia, përmes dhomës, dhe u fsheh poshtë komosë. Iku me një vrap të ngathët, aq sa mund ta kisha shkelur me këmbë po të doja, por ishte i këndshëm dhe i brishtë.

Fare pa ndonjë qëllim, të nesërmen ia përmenda Xhovanit, të zotit të shtëpisë.

-Aha, po, – tha ai, pa i dhënë rëndësi, – qëllon që del ndonjë mi nëpër shtëpi.

Kaloi një vit. Sapo futem në vilë, shoh dy mace të mëdha, me një gjallëri befasuese: mace me vija, muskulaturë prej atletësh, me gëzofin që u shkëlqen si atyre maceve që ushqehen me minj.

-Qenkeni vendosur, më në fund. – thashë - Kushedi sa e mbushin barkun! S'kanë për të vuajtur për minj këtu.

-Jo, përkundrazi. Rrallë hanë minj, me raste. Po të jetonin vetëm me minj ato...

-I shoh shumë të shëndetshme.

-Po, janë mirë, s'u mungon shëndeti. Kanë gjithë të mirat e Perëndisë në kuzhinë.

Kaloi edhe një vit tjetër dhe, kur futem në vilë, për pushimet e zakonshme, dy macet më dalin sërish përpara. S'duken më të shëndetshme e të shkathëta, por të dobësuara, kockë e lëkurë, të drobitura. Nuk rendin më nga njëra dhomë në tjetrën, përkundrazi, rrinë gjithnjë nëpër këmbët e të zotëve, si të përgjumura, pa dashur të marrin asnjë nismë. I pyes:

-Janë sëmure? Pse janë kaq të plogështa? Nuk kanë më minj për të ngrënë?

-E gjete! –tha Xhovani Korio, me gjallëri, e pastaj qeshi me të madhe – kanë varur turinjtë që kur s'ka më minj shtëpia. S'u ka mbetur as fara!

Më pas, Xhorxho, djali më i madh, më merr veç e më thotë me pamje komplotisti:

-E di si është e vërteta? Kanë frikë!

-Kush ka frikë?

-Macet, kanë frikë! Babai s'do që ta përmendim fare. E bezdis kjo bisedë, por është e sigurt që macet kanë frikë.

Brenda një viti, nga dhjetë që ishin, ato kafshë të ndyra janë bërë me qindra... e s'janë më ata miushët e atëhershëm. Janë si tigra. Më të mëdhenj se një urith, me gëzof të neveritshëm e të zi. Macet s'dinë t'i kapin!

Dhe vitin tjetër, që nga nata e parë, dëgjova një zhurmë të llahtarshme sipër tavanit të dhomës sime, sikur vraponin njerëz. Dhe e dija mirë që sipër s'kishte njeri, se aty ishte vetëm papafingoja e pabanueshme, plot me mobilie e arka të vjetra.

-Duket si këmbësori! – them me vete – Do të jenë bërë shumë të mëdhenj ata minj.

Këtë zhurmë dëgjoja derisa më zuri gjumi. Të nesërmen, pyes në tavolinë:

-S'do të bëni gjë për këta minjtë? Po bënin namin mbrëmë mbi tavan.

Xhovani më sheh me fytyrë të habitur.

-Minjtë?! Për çfarë minjsh e ke fjalën? Falë Zotit, s'kemi më asnjë mi në shtëpi.

Edhe prindërit e Xhovanit, pleqtë, që po rrinin në sallon, më thonë:

-Çfarë minjsh thua! Do t'i kesh parë në ëndërr, i dashur.

-Mos e beso babanë! Ato që dëgjove ishin minj, e ndonjëherë as ne s'na zë gjumi. Veç t'i shohësh, janë përbindës! Të zinj sterrë, me qimet që u ngrihen si gjemba. Dhe macet, sa për dijeni, i përzunë minjtë, ndodhi natën. S'kishim as dy orë që na kishte zënë gjumi, dhe na zgjuan mjaullimat e tmerrshme! Zbritëm poshtë, por macet s'dukeshin gjëkund. Gjetëm vetëm tufa qimesh e njolla gjaku gjithandej.

-Po si nuk merrni masa, xhanëm? Çarqe! Helme! S'e kuptoj si nuk shqetësohet yt atë!

-Po si jo! I është bërë makth. Por tani ka frikë edhe ai, thotë që më mirë të mos i provokojmë, se do të ishte më keq. Thotë që s'do të shërbente për asgjë, se tashmë janë shtuar shumë. Thotë që e vetmja zgjidhje është t'i vësh flakën gjithë shtëpisë. E di çfarë thotë tjetër? Është qesharake vetëm ta mendosh. Thotë që s'ia vlen t'u dalim kundër.

-Kujt t'u dilni kundër?

-Atyre, pra! Minjve!”

Minjtë janë të gjithë njësoj!

Edhe minjtë e tregimit të Buzzatit, edhe minjtë e kanaleve, edhe minjtë e ugareve, edhe ato të Bllokut, po, po, njësoj janë!

Pra, minjtë, edhe pse minj – hibrid, në fund të fundit, minj janë.

Ata miushët e dikurshëm, ata që nuk qenë të zot të thoshin një fjalë e të mbronin baballarët e tyre, kanë rilindur e janë rikthyer. Janë rikthyer si “Hibridë”.

-Ku janë? I gjeni kudo mes nesh, janë ministra, deputetë, këshilltarë, drejtorë, ambasadorë! Gjithkund, kudo! Kanë rilindur! Sepse edhe minjtë rilindin! Rilindja e minjve!

Përgjigjja është e thjeshtë, tmerrësisht e dhimbshme në të vërtetën e vet!

“Plaku Ziso Vangjeli gjatë luftës kishte zbarkuar në Normandi si oficer amerikan. Historian dhe ushtarak punoi në Paris, pastaj në një klub kulturor dhe iu dha të kthehej në Shqipëri”, na dëshmon në një prej librave të tij

shkrimtari Visar Zhiti. Sëmundja e dashurisë për atdhe. Sipas bisedimeve paraprahe, do të punonte si pedagog kur të kthehej në Tiranë. Ia fali shtetit gjithë bibliotekën e tij, por përfundoi në burg.

– “Kur të bjerë “komunizma”, – thoshte – se do të bjerë “patjetër”, ne do të vuajmë më pas me dekada prej hibridit... Bijtë e të kuqve do të vijnë etërit. Ajo përzierje zelli dhe inati, herë i fshehtë e herë i hapur për etërit e kuq, që s'patën fuqi dhe mend të ishin të përgjeshëm, do t'i bëjë më dinakë dhe më të ligj. Nga kundërshtarët e tyre që i urrejnë për vdekje, do të vjedhin idetë, projektet, madje edhe sloganet e do t'i propagandojnë më mizorisht për t'i vënë ata në jetë, gjoja si amanete. Dhe do të kërkojnë me çdo çmim zhdukjen e të zotëve të këtyre ideve. Do të kërkojnë pushtet të pamerituar si trashëgimtarë, si zanatçinj të kuq dhe kundërshtarët do t'i durojnë sa për sfond. Do të kërkojnë të bëhen ata pronarë dhe që të mbrohen do të bëjnë atë politikë që etërit e tyre e rroposën ose e luftuan gjithë jetën si bolshevikë të trashë. Kundërshtarët e të kuqve në Shqipëri, ç'kanë mbetur pas kasaphanave dhe të rinjtë që do të dalin janë të papërvujtë. Dhe kështu te ne do të sundojë hibridi. Gjatë, mjaft gjatë. Hibridët janë si monstrat. E për të luftuar ata duhet qenë si ata.

Do të jetë më keq ca kohë e njerëzit do të mendojnë diktaturën si zgjidhje. Burg i detyruar, liri e detyruar, kaos dhe llum. Pra, pas dënimit me burg, populli do të dënohet me liri qorre.

Liria qorre është si dënim, se ne nuk do të dimë se çfarë t'i bëjmë asaj si një gjëje të tepërt, do ta përdhunojmë si barbarët. Unë nuk do të jem atëherë, ju do të jeni! Mbajeni mend dhe kujtomëni! Nuk ke ç'bën jo, veç kujtomëni mua plakun! Nuk jam unë njeriu kundër komunistëve, por janë komunistët kundër njeriut!” Minjtë janë ringjallur, edhe pse si hibridë!

Faleminderit!

**Vasilika Hysi** – Faleminderit, zoti Rama!

Të nderuar kolegë,

Do të doja të përqendroheshim te çështja e rendit të ditës, që bën fjalë për nismën e kolegut Ndreu “Për një ndryshim dhe shtesë në ligjin nr. 8378, datë 22.07.1998 “Kodi Rrugor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar”, i cili është në interes të të gjithë shtetasve shqiptarë që banojnë jashtë vendit dhe që vijnë në Shqipëri, të cilët mund të kenë pasoja për shkak të shkëljes së rregullave të qarkullimit rrugor.

Ndaj, do t'ju lutesha, nëse keni çështje që janë të rëndësishme në gjykimin tuaj, të cilat nuk janë në rendin e ditës, mund të regjistroheni për të diskutuar në pikën e fundit të rendit të ditës, te 60-minutëshi.

Ndjesë që ju them, por parlamenti duhet të punojë në normalitet! Sot kemi projektligje apo marrëveshje me një kohë diskutimi prej 20 minutash, por kjo nuk do të thotë ta keqpërdorim atë!

Fjalën e ka deputetja Elisa Spiropali. Të përgatitet Endrit Braimllari dhe më pas deputeti Fatmir Mediu.

(Ndërhyrje nga salla pa mikrofon)

Zoti Mediu, në bazë të Rregullores, marrëveshja midis deputetëve mundëson ndryshimin e radhës.

**Fatmir Mediu** – Faleminderit, drejtuese e seancës!

Të nderuar kolegë deputetë,

Pa dyshim, edhe çka sjellin kolegët deputetë si ndryshim të ligjit për rregullat e qarkullimit rrugor, tregon edhe një herë se manipulimi dhe dhuna e shtetit nuk pyesin për të drejta edhe për një arsye të thjeshtë, sepse nuk ka më gjyqësor.

“Të gjitha të drejtat e qytetarëve, që garanton Kushtetuta, janë të pavlefshme, janë fluska, nëse nuk garantohen nga një pushtet gjyqësor i pavarur” - Andrey Jackson.

Të dashur kolegë deputetë,

Shqipëria dhe demokracia sot janë në krizën më të madhe ekzistenciale kushtetuese. Ne jemi në kushtet e një grushti shteti dhe banditizmi kushtetues, sepse nuk kemi Gjykatë Kushtetuese, nuk kemi Gjykatë të Lartë, së shpejti nuk do të ketë as gjykata apeli dhe as gjykata rrethesh, pra, nuk do të kemi sistem gjyqësor. Këtë po e pranojnë çdo ditë edhe ndërkombëtarët që ndodhen këtu.

Faktikisht shteti ka rënë, sepse një nga kolonat e tij më të rëndësishme, ajo e pushtetit gjyqësor, nuk ekziston dhe nuk funksionon. Kjo është një situatë skandaloze dhe alarmante, që duhet të na bëjë të gjithëve të mendohemi. Ne jemi kthyer në republikë bananesh dhe Republika parlamentare kushtetuese ka pushuar së funksionuari. Çdo republikë parlamentare kushtetuese ka tri pushtete bazë, që garantojnë funksionimin e shtetit dhe të drejtat e shtetasve.

Ato janë të ndara, të pavarura dhe ndërveprojnë bazuar në parimin *check and balance*.

Rënia e pushtetit gjyqësor do të thotë rënie e shtetit, por, mbi të gjitha, rënie e interesave dhe e të drejtave të qytetarëve, sepse është pushteti gjyqësor ai që mbron qytetarin nga abuzimi i shtetit, i qeverisë, i parlamentit; është gjyqësori që garanton dhe detyron zgjedhjen dhe zgjidhjen e të drejtave të tij.

Kjo situatë nuk është më hipotetike, por është realitet në Shqipëri. Si në asnjë vend tjetër në rajon apo në Europë, sot kemi vetëm një pushtet dhe një njeri që kontrollon gjithçka. Rama *de facto* është Gjykatë Kushtetuese, është Gjykatë e Lartë, është kryeprokuror, është ligjvënës dhe zbatues, është përcaktuesi dhe mohuesi i të drejtave të shqiptarëve, është biznesi, është ligji dhe antiligji.

Kjo situatë është sa e paprecedentë, aq edhe dramatike. Madje, edhe Enver Hoxha, diktatori famëkeq, të paktën formalisht kishte gjykata, hetuesi dhe prokurori, ndërsa sot po shkojmë drejt një shteti pa asnjë hallkë të gjyqësorit.

Të gjithë kemi qenë pro reformës në drejtësi, kemi qenë pro vetingut dhe ndryshimeve kushtetuese, por që në fillim Komisioni i Venecias me shqetësim në vlerësimet e tij theksoi: “Në qoftë se kjo reformë nuk do të aplikohet me kujdes, do të sjellë një goditje të rëndë dhe të pakthyeshme për sistemin e drejtësisë”, dhe ja ku jemi sot.

A ka ndonjë vend europian pa pushtet gjyqësor? A mund të ndodhë në Amerikë që të mos ketë Gjykatë të Lartë? Atëherë, pse kjo po ndodh në Shqipëri? Pse e filloi Rama vetingun nga Gjykata Kushtetuese, Gjykata e Lartë, si dhe kandidaturat për KLD-në dhe KLP-në? Pse i intereson qeverisë shkatërrimi i gjyqësorit?

Së pari, sepse pa Gjykatë Kushtetuese ai aprovon çdo ligj antikushtetues dhe askush nuk mund ta kundërshtojë.

Së dyti, sepse pa gjyqësor ai mund të cenojë çdo të drejtë të qytetarëve, të tjetërsojë prona publike dhe private për interesa korruptive, siç po ndodh në bregdet apo me Teatrin Kombëtar. Askush nuk ankohet dot në Gjykatën Kushtetuese, se ajo nuk ekziston më; askush nuk shkon dot në Gjykatën e të Drejtave të Njeriut në Strasburg, sepse më parë duhet të ezaurojë shkallët e gjyqësorit në Shqipëri, por gjykatat nuk ekzistojnë më.

Dua t'ju kujtoj se Gjykata e Strasburgut për çështjen e pronave e ka paditur dhe e ka detyruar shtetin shqiptar që t'u paguajë pronarëve të ligjshëm me qindra milionë euro. Kurse sot asnjë pronar që i cenohet e drejta nuk shkon dot në Strasburg, sepse paraprakisht duhet të ankimohet në një gjykatë që nuk ekziston, siç është Gjykata Kushtetuese.

Së treti, qytetarët nuk mund të organizohen kundër dhunës së pushtetit, nuk mund t'i gëzojnë dot të drejtat e tyre, sepse këto të drejta referendare, pa një sistem gjyqësor, janë të drejta të mohuara.

A mundet që të zgjidhen padrejtësitë e shtetit dhe çështjet korruptive në dëm të qytetarëve, në dëm të biznesit? Absolutisht jo, sepse nuk ka më Gjykatë të Lartë. Janë mbi 20 mijë dosje të pashqyrtuara në këtë gjykatë. Sot në proces shqyrtimi janë dosjet e vitit 2014. Pra, po shqyrtohen dosjet e para 4 vjetëve dhe mosfunksionimi i kësaj gjykate do t'i çojë këto dosje në kalendrat greke.

Para disa ditësh në *hard talk* në BBC-i, gazetari ishte në një intervistë me ministrin e Drejtësisë së Indisë dhe e konsideronte skandal që në Gjykatën e Lartë të Indisë ishin rreth 50 mijë dosje të pashqyrtuara. India ka një popullsi me rreth 1,3 bilionë banorë. Kurse në Shqipëri që janë 2,8 milionë banorë, janë 20 mijë çështje të pashqyrtuara. Faktikisht, ne kemi ngelur vetëm 1 milion banorë, sepse shqiptarët e tjerë kanë ikur për shkak të kësaj situatë të papranueshme. India ka 18 gjyqtarë të Gjykatës së Lartë, kurse Shqipëria ka 17 gjyqtarë.

Shikoni padrejtësinë dhe abuzimin e shtetit kundrejt qytetarëve që shkojnë në Gjykatën e Lartë. Abuzimi i përditshëm i institucioneve shtetërore në raport me të drejtën është kolosal. Ky volum problemesh do të shtohet gjithnjë e më shumë dhe qytetarët asnjëherë nuk kanë për ta gjetur të drejtën e tyre.

Qeveria dhe maxhoranca nuk u morën vetëm me Gjykatën e Lartë, nuk u morën vetëm me Gjykatën Kushtetuese, por, nga ana tjetër, mohuan edhe një element shumë të rëndësishëm të kësaj reforme: ngritjen e institucioneve të rëndësishme, që kishin të bënin me emërimet në drejtësi, në KLD dhe KLP, duke e penguar dhe duke e sabotuar atë.

Madje, edhe ata që guxuan të mendonin në mënyrë të pavarur, që besonin në aftësitë dhe

vlerat e tyre si gjyqtarë dhe prokurorë për t'u bërë pjesë e këtyre organeve të rëndësishme dhe që konkurruan, duhet të kalonin një herë në sitën e partisë, nëse ishin ose jo njerëz të besueshëm të partisë, para se të kalonin në shkallën e dytë të vlerësimit të tyre politik, pra në sitën e vetingut, të bërë përsëri nga partia.

Gjyqtarët që besonin në integritetin e tyre, u përjashtuan nga e drejta për të qenë anëtarë të KLD-së dhe KLP-së, pavarësisht nëse ishin të majtë apo të djathtë. Po marr rastin e një gjyqtari të krahut të majtë, i cili njihet për funksionin e tij në institucionet kushtetuese. Ai ishte propozuar nga Partia Socialiste, por pati guximin një apo dy vjet më parë t'i thoshte Kryeministrit se ishte ushtar i ligjit dhe jo ushtar i partisë, se socialist nuk e kishte bërë Edi Rama, por bindja e tij, dhe tani që ishte bërë gjyqtar nuk mund të merrte urdhra prej tij për të liruar njerëz nga burgu apo për të futur në burg njerëz të opozitës. Ky gjyqtar i shkallës së parë u skualifikua. Unë nuk dua të përmend emra, sepse ju, me një analizë të thjeshtë, mund ta kuptoni se për kë bëhet fjalë. Sot ky gjyqtar diskutohet se ka shtuar me 1,7 pasurinë e tij, ndërkohë që sitën e vetingut e kanë kaluar ata që e kanë shtuar me 17 herë pasurinë e tyre. Ky lloj vetingu dhe kjo lloj marrëdhënieje është vetëm për të kontrolluar dhe për të shkatërruar sistemin gjyqësor.

Sot nuk ka as KLD, as KLP dhe as gjyqësor, sepse nuk mund të emërohet më askush. Sot 90% e gjyqeve kundër qeverisë, fitohen nga qeveria, ndërkohë që para vetingut mbi 87% e gjyqeve fitoheshin nga qytetarët. Avokati i Shtetit krenohet dhe thotë: "Ne kemi fituar". Jo, ju nuk keni fituar, por po kontrolloni pushtetin gjyqësor, duke shkelur pafundësisht të drejtat dhe liritë e qytetarëve shqiptarë, të cilat po i mohoni çdo ditë.

Gjyqësori gjykon padrejtësisht dhe në mënyrë të padiskutueshme interesat politike, në vend që të diskutojë interesat e ligjit. Ai duhet të gjykojë korrupsionin e qeverisë në rastet më të shumta, prandaj për qeverinë ai nuk duhet të ekzistojë.

Përveç kësaj situatë absurde, qeveria, njësoj si në diktaturë, ka filluar një propagandë bajate: më mirë pa gjyqësor, sesa me gjyqtarë të korruptuar. Kjo është marrëzia e një shteti, që do të bëhet pjesë e BE-së; kjo është marrëzia e propagandës bajate "alla komuniste".

Kryeministri thotë se ne udhëhiqemi nga pasioni për Shqipërinë. Ne nuk jemi këtu për të gjykuar pasionet, sepse ato mund t'i kemi të ndryshme. Kryeministri i një vendi duhet të ketë vetëm një pasion: të jetë ushtar i bindur i Kushtetutës, i ligjit dhe i rregullave, jo i dëshirave dhe pasioneve të tij, që s'kanë asgjë të përbashkët me shtetin, ekonominë apo të drejtën.

Shqipëria po kthehet në një lloj Kalifati, ku Kalifi kontrollon çdo gjë, por ky Kalifi ynë nuk është i bazuar te feja, por te pushteti dhe paraja, që kërkon të kontrollojë çdo gjë

Edhe Enver Hoxha ishte pasionant, donte ta bënte Shqipërinë “fanar ndriçues” dhe u bë ligj, maliq dhe kalif i fesë komuniste dhe e shkatërroi vendin duke e çuar në prag të inekzistencës.

Komunizmi ishte pasioni i fjalëve të bukura dhe i veprave të tmerrshme antinjerëzore. I njëjti pasion është ngjallur edhe sot me këtë pushtet

Të jesh krenar me injorancën, është fatkeqësi; të jesh krenar me maskarallëkun, është poshtërsi. Kjo situatë po cenon interesin dhe sigurinë tonë kombëtare, të të gjithë shqiptarëve kudo që janë. Ka disa ide që ne duhet të shtojmë kuotat në Magjistraturë, sepse kështu do ta zgjidhnim problemin. Ku do t'i gjejmë ne anëtarët për në Gjykatën e Lartë apo në Gjykatën Kushtetuese, sepse duhet eksperiencë disavjeçare në gjyqësor?

A e dini ju se për t'u futur në konkursin e Magjistraturës duhet të kesh një mesatare të vlerësuar sipas sistemit arsimor shqiptar dhe studentët që kanë mbaruar në Harvard, Bokon, Columbia University apo Oksford me një mesatare më poshtë se 8, nuk kanë të drejtë të konkurrojnë në Magjistraturë?! Kjo është absurde, sepse mesatarja 7 apo 8 e këtyre universiteteve, që janë më të njohurat në botë, është shumë e lartë (pjesa tjetër është superekselente), por nuk mund të të kualifikojë për të konkurruar në Magjistraturë dhe për t'u bërë gjykatës. Ky është sistemi që ne kemi dhe kjo është marrëzia, për të cilën ne vazhdojmë të këmbëngulim. Ka dhe nga ata që thonë: “Hë mo, se shqiptarë janë këta, ku dinë se ç'janë dhe pse duhen gjykatat. Nuk ka problem që të rrinë disa kohë pa gjykata”. Ata thonë atë që nuk do të guxonin kurrë ta thoshin për vendet e tyre.

Ka nga ata që thonë që të marrim gjyqtarë të huaj, si në Kosovë me EULEX-in, sepse kjo do të ishte një zgjidhje. A nuk është mjerim për

ne, që duam të jemi një vend i BE-së, të ecim pa kolonën më të rëndësishme të shtetit, pushtetin gjyqësor? Çfarë duam të jemi ne në BE? Tualeti i BE-së apo duam të jemi një vend dinjitoz? Këto janë disa pyetje që duhet t'u kthejmë përgjigje, të nderuar kolegë deputetë.

Nëse dikush mendon se mund të silllet me këtë popull, si ai arxhiu që i vendos zinxhirin në hundë ariut dhe i bie defit, duke e detyruar të silllet vërdallë, sepse kështu kënaqen njerëzit, duhet të kuptojë se shqiptarët i këputën zinxhirët e diktaturës dhe do të këpusin edhe zinxhirët e krimit dhe të korrupsionit. Mjerë ata që do të përballen me vrullin dhe urrejtjen e qytetarëve.

Kolegë deputetë, të majtë dhe të djathtë, kjo situatë e turpshme kërkon zgjidhje këtu në parlament, sepse jam i bindur se qeveria është më se e lumtur me këtë situatë! Kjo zgjidhje nuk mund të jetë as e majtë dhe as e djathtë, por duhet të jetë kushtetuese. Prandaj, në mënyrë urgjente, ne duhet të mblidhemi dhe të thërrasim specialistët më të mirë të së drejtës kushtetuese për të parë nëse kemi një Kushtetutë funksionale dhe si mund të ndërtojmë një sistem gjyqësor të pavarur. Ne duhet të thërrasim specialistë të Kushtetutës, të cilët janë marrë me të drejtën kushtetuese dhe kanë bërë kushtetutat në vendet e tyre, jo njerëz të rastësishëm, që vijnë dhe na japin leksione për Kushtetutën. Në vitin 1998 ne kemi pasur Pol Xhonsin, përfaqësuesin më të lartë të kushtetutshmërisë greke, italiane e kështu me radhë. Ne nuk mund ta lemë vendin tonë në mëshirën e gjykimit të idiotëve politike apo të interesave të ngushta për të shkatërruar të ardhmen e këtij vendi.

Faleminderit!

**Vasilika Hysi** – Faleminderit, zoti Mediu!

Fjalën e ka zoti Spaho, për procedurë.

**Edmond Spaho** - Zonja drejtuese e seancës,

Në seancën e kaluar grupet opozitare kërkuar që të rivotohet ligji për prishjen e Teatrit Kombëtar, pasi një nga deputetët e maxhorancës kishte votuar në emër të një deputeti të opozitës.

Kryetari i Kuvendit porositi që të mblidhej Këshilli i Votimeve dhe i Procedurave, i cili u mblodh dhe vërtetoi qëndrimin e opozitës, se votimi ishte kryer në emër të një deputeti të opozitës, pavarësisht pretendimeve të palëve se kush e kishte kryer. Prandaj, për sa kohë që ky

votim nuk ka qenë i rregullt, në përputhje me Rregulloren, duhet të përsëritet.

Për rrjedhojë, në emër të grupeve të opozitës, unë vazhdoj të kërkoj që të rinovohet ligji për Teatrin, pasi votimi ka qenë i parregullt. Për shkak se ju nuk po lejoni të korrigjohet ky veprim i gabuar, në shenjë proteste, ne do të largoheni nga kjo seancë, pasi nuk mund të qëndrojmë në një parlament ku vidhet vota edhe kur nuk është nevoja për ta vjedhur atë.

Faleminderit!

**Vasilika Hysi** - Faleminderit!

*(Deputetët e opozitës largohen nga seanca)*

Ditë të mbarë kolegëve të opozitës!

Fjalën e ka Taulant Balla për procedurë.

**Taulant Balla** – Në fakt, do të ishte mirë që opozita, kryetari i grupit të saj, zoti Spaho, kur bën një kërkesë, duhet që minimalisht të respektojë edhe përgjigjen.

Kam këtu procesverbalin e seancës së kaluar të Kuvendit të Shqipërisë, e cila është mbyllur me vendimin e bërë publik nga Kryetari i Kuvendit, zoti Ruçi, lidhur me një kërkesë të të dy kryetarëve të grupeve parlamentare të opozitës, të Partisë Demokratike dhe Lëvizjes Socialiste për Integrim për pretendimin e paraqitur, se pse deputeti Bitri ka votuar me kartën e aksesit në sistemin e votimit të zotit Tavo.

Unë mendoj se publikisht kjo çështje është sqaruar. Aq mirë është sqaruar, saqë nëse ka një faj për këtë çështje, i gjithi u takon deputetëve të caktuar nga krahu i opozitës, të cilët janë munduar të bëjnë një rreng ndaj një deputeti që ka qenë pjesë e atij grupi dhe prej pak kohësh është vetëdeklaruar si deputet i pavarur në Kuvendin e Shqipërisë. Bëhet fjalë për deputetin e nderuar, zotin Bitri.

E gjithë kjo çështje është e sqaruar. Sa kohë që është e sqaruar, më vjen shumë keq që opozita bojkoton vetëm dy ditë pas vizitës së komisionerit Hahnn në Shqipëri, me të cilin dhe me komisionin që ai përfaqëson, qeveria filloi punën intensive parapërgatitore për hapjen e negociatave. Por thirrjes që komisioneri Hahnn i bëri opozitës, por edhe thirrjes që Këshilli European i bëri opozitës që të mos bojkotojë Kuvendin, opozita i përgjigjet me të njëjtën gjuhë.

Siç e dini të gjithë, shqiptarë dhe shqiptare kudo që jeni, sot në seancën e Kuvendit të Shqipërisë ka përsëri dy projektligje të rëndësishme, të cilat kërkojnë një maxhorancë të cilësuar. Propozimi i deputetit Ndreu u vjen në ndihmë shqiptarëve dhe shqiptareve, që jetojnë jashtë territorit të Shqipërisë, të cilët malli për familjen, për vendin i bën të kthehen dhe për drejtimin e automjeteve të përdorin lejet e drejtimit të vendeve nga vijnë. Edhe vëllezërit dhe motrat tona kosovare, të Maqedonisë, të Malit të Zi dhe të Preshevës, të cilët përdorin leje drejtimi të vendeve nga vijnë, sot mezi presin që ne ta votojmë këtë ndryshim, i cili kërkon shumicë të cilësuar.

Zonja Nënkrjetare e Kuvendit, më lejoni të vazhdoj duke thënë se përveç kësaj kemi edhe një projektligj mjaft të rëndësishëm. Këtu po risjell në vëmendje kërkesën e ardhur nga komisioneri Hahnn drejtuar opozitës, se nuk kanë asnjë arsye të qenësishme që përmes një bojkoti të shpikur për një çështje që nuk ekziston, të bllokojnë votimin në Kuvend, shtyrjen qoftë edhe vetëm me një vit.

Jam i gatshëm të bëj një propozim në emër të Grupit Parlamentar të PS-së drejtuar opozitës, në mënyrë të veçantë LSI-së, të cilët e kanë bashkëvotuar me ne këtë draft që është gati: të mos e shtyjme për dy vjet, por ta shtyjme vetëm për një vit, për vitin shkollor 2018-2019, të Magjistraturës, për të pranuar 50 djem dhe vajza ekselentë në drejtësi, për të vijuar karrierën e tyre në profesionin që sot është më i nevojshmi dhe më i dobishmi për forcimin e shtetit të së drejtës në Shqipëri, sikurse është Magjistratura, sepse do të jenë këta magjistratë të rinj, qofshin gjyqtarë apo prokurorë, që do të plotësojnë këto vakanca që vetingu po krijon me të drejtë.

Dëgjova këtu deputetin Fatmir Mediu, të ankohej për sistemin e drejtësisë, i cili tha: “Sot kemi vakanca në Gjykatën Kushtetuese apo në Gjykatën e Lartë”. Përse e bëmë ne vetingun, që të qëndronin ata që ishin? Kush nuk e ka ditur që vetingu do të prodhonte vakanca, nuk e paska ditur çfarë ka votuar sot e dy vjet në këtë seancë.

Për pak ditë, për tri ditë, bëjmë dy vjet nga momenti që kemi votuar me 140 vota në këtë sallë paketën kushtetuese të reformës në drejtësi. Vetingu i prodhoi vakancat. Kush është kundër plotësimit dhe vijimit të vitit shkollor nga

Magjistratura, sigurisht që është duke votuar kundër vetvetes për atë që ka votuar dy vjet më parë.

Zonja Nënkyetare e Kuvendit, po i rikthehem procedurës. Më lejoni t'ju propozoj që, për hir të dialogut të rëndësishëm me një pjesë ende të përgjegjshme të opozitës, qoftë ky ligj, qoftë propozimi i deputetit, që është edhe ekspert, ndër më të mirët e fushës, zotit Ndreu, qoftë edhe projektligji tjetër për ndryshimet në ligjin "Për statusin e gjyqtarëve dhe të prokurorëve" që mbart në vetvete dhe amendamentet që bëjnë të mundur hapjen e pranimeve të reja në Shkollën e Magjistraturës të shtyhen për seancën e datës 23, duke shpresuar që kolegu im i nderuar, zoti Spaho, nuk do të vijë më të recitojë vjershën e radhës se në Kuvendin e Shqipërisë, në seancën e datës 5 korrik paska ndodhur hataja më e madhe për demokracinë në këtë vend, sikurse bëhet fjalë për votimin, që siç e dimë Sekretariati, ku merr pjesë edhe opozita, dhe këtu është e gjithë përgjigjja, ka votuar për këtë çështje dhe e ka marrë vendimin përfundimtar. Vendimi i Sekretariatit është rekomandim drejtuar Kryetarit të Kuvendit. Në fund të fundit, Kryetari i Kuvendit është shprehur me një vendim të bërë publik në seancën e kaluar.

E falënderoj opozitën që ishte në një moment të rëndësishëm përkujtimor për një figurë të rëndësishme të opozitës, sikurse është Pjetër Arbnori, por nëse do të ishte Pjetër Arbnori gjallë sot, (do të ishte mirë të ndiqnin sado pak edhe mendimet e vyera të tij), Partia Demokratike do të ishte sot në sallën e Kuvendit.

Shumë faleminderit!

*(Drejtimitin e seancës e merr zoti Gramoz Ruçi)*

**Gramoz Ruçi** - Zoti Balla, edhe një herë, kërkuat shtyrjen për votim apo edhe për diskutime?

**Taulant Balla** – Shumë faleminderit, zoti Kryetar që më jepni mundësinë ta risqaroj!

Atëherë për projektligjin "Për disa ndryshime në Kodin Rugor të Republikës së Shqipërisë", diskutimi quhet i ezauruar, sepse deputetët e morën fjalën. Kjo mbartet vetëm për votim.

Ndërsa për ligjin tjetër "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve" unë besoj dhe shpresoj se opozita ditën e hënë të ketë

reflektuar për këtë kërkesë dhe këtë detyrim që ka Kuvendi i Shqipërisë dhe në kuadër të vijimit të implementimit të reformës në drejtësi, të kemi mundësinë për ta pasur një çështje të hapur për diskutime, ku mirëpresim edhe diskutimet e opozitës.

Faleminderit!

**Gramoz Ruçi** - Faleminderit!

Këtu përfundon debati për Kodin Rugor të Republikës së Shqipërisë, të ndryshuar. Kalon në seancën pasardhëse për votim.

Vazhdojmë me projektligjin tjetër "Për ratifikimin e marrëveshjes me vendin pritës ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Fondit të Ballkanit Perëndimor".

Zonja Elona Hoxha, e ka fjalën.

**Elona Hoxha** – I nderuar zoti Kryetar,

Të nderuar deputetë,

Me nënshkrimin e Marrëveshjes së Stabilizim -Asociimit Republika e Shqipërisë, ndër të tjera, merr përsipër të angazhohet në zhvillimin e bashkëpunimit rajonal dhe ndërkombëtar, si dhe në zhvillimin e marrëdhënieve të fqinjësisë së mirë, prej nga i lind edhe detyrimi për nënshkrimin e marrëveshjeve dypalëshe, synimi i të cilave është rritja e fushave të bashkëpunimit dhe përforcimi i këtij bashkëpunimi ndërmjet vendeve në fjalë, siç është edhe marrëveshja për themelimin e Fondit të Ballkanit Perëndimor.

Kjo marrëveshje ndihmon në zbatimin e marrëveshjes për themelimin e Fondit të Ballkanit Perëndimor, e cila përbën një objektiv strategjik për anëtarësimin e plotë të Shqipërisë në Bashkimin Europian, nëpërmjet evidentimit të rolit të saj konstruktiv në rajon.

Qëllimi i këtij Fondi është nxitja e bashkëpunimit ndërmjet vendeve anëtare, forcimi i lidhjeve midis tyre, integrimi drejt Bashkimit Europian dhe NATO-s, promovimi i vlerave të përbashkëta mes qytetarëve, shoqërisë civile dhe institucioneve të rajonit të Ballkanit Perëndimor, duke siguruar një qasje konkrete në nivelin "people-to-people" për popujt e vendeve anëtare, duke ndihmuar në ruajtjen, konsolidimin e paqes dhe stabilitetit demokratik.

Këto qëllime Fondi synon t'i realizojë përmes mbështetjes së projekteve të përbashkëta. Kjo gjykohet si rruga më e mirë për të afruar njerëzit, për të shkëmbyer eksperiencat e

ndërsjella, për të njohur më mirë vlerat, traditat dhe kulturën e vendeve respektive.

Procesi i përgatitjes dhe i zbatimit të projekteve nga aktorët rajonalë, përfaqësues të shoqërisë civile, të komunitetit të biznesit, institucioneve qendrore apo në nivel lokal, gjykohet se do t'i shërbejë rritjes së kapaciteteve për të përgatitur në të ardhmen projekte më të mëdha dhe më komplekse.

Fondi i Ballkanit Perëndimor do të financojë projekte të vogla dhe të mesme, që synojnë rritjen e bashkëpunimit rajonal, ndërkufitar dhe forcimin e kohezionit rajonal në këto fusha kryesore si: edukimi, arsimi, mbrojtja e mjedisit, të drejtat e njeriut, kultura, shkëmbimet ndërkufitare dhe bashkëpunimi rinor.

Ky Fond vjen në një moment mjaft të rëndësishëm për Shqipërinë, që aspiron për t'u bërë pjesë e familjes europiane. Para nesh janë dy procese:

Së pari, thellimi i reformave bazuar te detajimi i 5 prioritetëve që ka bërë vetë Këshilli i Bashkimit Europian, që janë bashkudhëtarët tona në këtë proces, si dhe fuqizimi i kapaciteteve njerëzore dhe administrative në funksion të përgatitjes së hapjes së bisedimeve për anëtarësim.

Në këtë kuptim projektet e Fondit të Ballkanit Perëndimor dhe jo vetëm do të ndihmojnë në konsolidimin e këtyre reformave. Mekanizmi i aplikimit për financimin do të jetë i thjeshtë dhe i arritshëm si për individët, ashtu edhe për organizatat rinore, rrjetet rajonale të shoqërisë civile, komunitetin e biznesit, institucionet kërkimore dhe akademike.

Nga ana tjetër, zbatimi i marrëveshjes nuk sjell asnjë efekt nga pikëpamja buxhetore. Formalizimi i këtij procesi nëpërmjet ratifikimit të marrëveshjes me vendin pritës, ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Fondit të Ballkanit Perëndimor, përveç rëndësisë në kuadër të bashkëpunimit rajonal, është përfundim i natyrshëm i përpjekjeve të mëdha diplomatike për të sjellë në vend për herë të parë selinë e një nisme rajonale. Diplomacia jonë në këto vite të qeverisjes së zotit Rama ka dëshmuar se është në lartësinë e duhur për një shtet dinjitoz që aspiron për një vend të merituar në familjen europiane.

Si rezultat i kësaj pune, përveç arritjeve të tjera, vlen të theksohen dy arritje dhe momente të

rëndësishme: marrja e statusit kandidat në vitin 2014, si dhe marrja e afatit kohor në qershor të vitit 2019 nga Këshilli i BE-së për çeljen e bisedimeve për anëtarësim. Shqipëria ia doli një sfide tejet të vështirë, në kushtet ku u zhvillua debati mes shteteve anëtare për çeljen e negociatave dhe jemi besimplotë për arritjet që duhen të konsolidohen në vijim.

Të nderuar deputetë, ju ftoj ta miratojmë këtë projektligj të rëndësishëm!

Faleminderit!

**Gramoz Ruçi** – Faleminderit, zonja Hoxha!

Fjalën e ka zonja Gjermani.

Të përgatitet zonja Spiropali.

**Eglantina Gjermani** - Faleminderit, zoti Kryetar!

Të nderuar kolegë deputetë,

Kur flasim për vendet e Ballkanit Perëndimor, shpesh mendja na shkon te secili prej vendeve të rajonit, tek të veçantat dhe karakteristikat e tyre, duke u fokusuar më shumë tek ato çfarë na ndajnë, se sa tek ato që na bashkojnë.

Vërtet vendet e Ballkanit Perëndimor janë të ndryshme në histori, gjuhë, nivele zhvillimi, por njëkohësisht kanë shumë të përbashkëta, pika lidhëse, që i kanë bërë bashkë për hir të sfidave me të cilat janë përballur dhe vazhdojnë të përballen.

Sot që flasim, e përbashkëta e vendeve tona, përveç faktit se bëjmë pjesë në Ballkanin Perëndimor, është ëndrra për t'u bërë pjesë e Bashkimit Europian, si një aspiratë që na afron më shumë me njëri-tjetrin, duke na dhënë një mesazh të qartë se ajo çka na bashkon është shumë më tepër se ato që mund të na ndajnë. Pikërisht kësaj ëndrrë apo aspiratë të përbashkët i shërben edhe Fondi i Ballkanit Perëndimor, duke u krijuar më shumë hapësira e mundësi organizatave të shoqërisë civile, universiteteve dhe institucioneve, që të konkurrojnë me projekte për zhvillim të qëndrueshëm dhe rritje të mirëqenies së qytetarëve tanë.

Krijimi i Fondit të Ballkanit Perëndimor konsiderohet si një vendim i rëndësishëm politik, por gjithashtu dhe një shenjë e rëndësishme pozitive e mentalitetit të ri të bashkëpunimit mes vendeve të Ballkanit Perëndimor, konkretisht Shqipërisë, Bosnjë – Hercegovinës, Kosovës, Malit të Zi, Maqedonisë dhe Serbisë.

Qëllimi i këtij Fondi është nxitja e bashkëpunimit ndërmjet vendeve anëtare, forcimi i lidhjeve mes tyre, integrimi në Bashkimin Europian dhe NATO, promovimi i vlerave të përbashkëta mes qytetarëve, shoqërisë civile dhe institucioneve të rajonit të Ballkanit Perëndimor, duke siguruar një qasje konkrete në nivelin njerëz me njerëz, *people to people*, për popujt e vendeve anëtare, duke ndihmuar në ruajtjen dhe konsolidimin e paqes dhe stabilitetit demokratik.

Me nënshkrimin e Marrëveshjes së Stabilizim – Asociimit, ndër të tjera, Republika e Shqipërisë merr përsipër të angazhohet në zhvillimin e bashkëpunimit rajonal dhe ndërkombëtar, si dhe në zhvillimin e marrëdhënieve të fqinjësisë së mirë, prej nga lind edhe detyrimi për nënshkrimin e marrëveshjeve dypalëshe për bashkëpunimin rajonal.

Këto marrëveshje synojnë rritjen e fushave të bashkëpunimit dhe përf forcimin e këtij bashkëpunimi ndërmjet vendeve në fjalë, siç është edhe marrëveshja për themelimin e këtij fondi. Konkretisht, vetë misioni i Fondit, e për më tepër ideja e krijimit të tij nga vetë përfaqësuesit e vendeve të këtij rajoni, demonstrojnë vullnetin dhe angazhimin politik të qeverive respektive për forcimin e marrëdhënieve mes vendeve tona, rritjen e mëtejshme të bashkëpunimit në rajon drejt proceseve të integritetit europian.

Fondi synon ta realizojë misionin e tij përmes mbështetjes së projekteve të përbashkëta. Kjo gjykohet si rruga më e mirë për të ofruar njerëzit, qytetarët e vendeve tona, për shkëmbimin e përvojave të ndërsjella, për njohjen më mirë dhe promovimin e vlerave, traditave dhe kulturës së vendeve respektive.

Procesi i përgatitjes dhe i zbatimit të projekteve nga aktorët rajonalë, përfaqësues të shoqërisë civile, komuniteti i biznesit, institucionet qendrore apo vendore, pa dyshim që do t'i shërbejë rritjes së kapaciteteve, për të përgatitur në të ardhmen projekte më të mëdha e më komplekse.

Në datën 7 maj 2018, Fondi i Ballkanit Perëndimor organizoi aktivitetin me moton “Fondi i Ballkanit Perëndimor, një instrument i rëndësishëm për rritjen e bashkëpunimit rajonal dhe *people to people contact*”, kontaktet mes

njerëzve me organizata që dhanë grante për thirrjen e parë të këtij fondi.

Gjatë këtij aktiviteti janë vlerësuar 18 projekte, të cilat përfshijnë 84 organizata partnere nga universitetet, shkollat, shoqatat e kulturës, artit, sportit dhe institucioneve të tjera nga Ballkani Perëndimor, duke thelluar kështu procesin simbolik të zbatimit të tij.

Duke përgëzuar Ministrinë e Jashtme, në veçanti ministrin, por edhe ekipin e tij, për gjithçka ka arritur, për faktin se ky Fond e ka selinë në Tiranë, gjë që tregon edhe një herë rolin proaktiv të Shqipërisë në këtë bashkëpunim, i uroj suksese në zbatimin e projekteve që janë mbështetur nga ky Fond, si dhe frymëzimin për projekte të tjera më afatgjata për zhvillimin e mëtejshëm të Ballkanit Perëndimor.

Faleminderit!

**Gramoz Ruçi** – Një minutë, zonja Spiropali, do ta marrë fjalën ministri Bushati!

**Ditmir Bushati** – Faleminderit, zoti Kryetar,

Të nderuar kolegë deputetë,

Duke qenë se kjo është një nismë që vjen nga qeveria shqiptare, në radhë të parë dua të theksoj faktin se është selia e parë rajonale që vendoset në Shqipëri. Fondi për Ballkanin Perëndimor, që grupon të gjashtë vendet e Ballkanit Perëndimor, ka edhe drejtorin ekzekutiv, i cili, gjithashtu, në këtë mandat të parë, i përket Shqipërisë.

Dua të shpreh falënderime, për kolegët deputetë, që e kanë shqyrtuar këtë nismë, e cila është formale, sepse ka të bëjë me funksionimin e Fondit, me raportet që vendosen me shtetin mikpritës, që është Shqipëria, që gjatë diskutimeve në Kuvend kanë qenë mbështetës të projekteve që do të zbatojë Fondi, në të njëjtën kohë inkurajues për qeverinë shqiptare dhe qeveritë e vendeve të tjera të rajonit të Ballkanit Perëndimor, për të vendosur më shumë angazhime të karakterit financiar e jo thjesht politik, me qëllim transformimin e kësaj nisme në një histori suksesi.

Falënderimi i dytë shkon për vendet e Vishegradit, duke qenë se kjo është një praktikë e bashkëpunimit rajonal, që pasqyron deri diku bashkëpunimin rajonal të vendeve të Vishegradit. Edhe atje nisi në mënyrë simbolike, me një fond simbolik, por me kalimin e viteve,

për shkak të vullnetit politik të demonstruar nga qeveritë, u fuqizua.

Së treti, në emër të qeverisë, dua të siguroj kolegët deputetë, por jo vetëm, se shumë shpejt do të vijë edhe marrëveshja për zyrën apo për selinë tjetër që është vendosur në Tiranë, për Fondin e Bashkëpunimit Rinor Rajonal. Edhe këtu do të jetë një praktikë e ngjashme me këtë që po kalojmë sot, por me një fokus të veçantë të çështjet e bashkëpunimit rinor, sepse, siç dihet, ishte një iniciativë mes Kryeministrit Rama dhe Vuçiç, që ishte Kryeministër asokohe, por e mbështetur edhe nga praktika më e mirë e ndërtimit të marrëdhënieve në këtë gjeneratë, pra të rinjtë, që është praktika franko-gjermane.

Në do t'i mbështesim fuqimisht këto nisma, jo vetëm në kuptimin politik, financiar e logjistik, sepse besojmë se një prani më e shtuar e selive rajonale në Tiranë, jo vetëm flet qartë për një qëndrim më të balancuar të nismave në rajonin tonë, por është edhe dëshmi e pjekurisë së Shqipërisë dhe rolit gjithnjë e më në rritje të saj, për sa i përket politikës së jashtme në rajon.

Gjithashtu, duke marrë shkas nga diskutimet që kanë bërë të gjithë kolegët: Gjermani, Spiropali e të tjerë, por edhe nga diskutimet që janë bërë gjatë shqyrtimit të këtij projekti në komisionet parlamentare, ne mbetemi të angazhuar për të përfshirë në këto procese, aq më tepër tani që filloi edhe procesi përgatitor për bisedimet për anëtarësim në Bashkimin Europian, të gjitha grupet e interesit, sidomos të rinjtë, duke qenë se ata do të jenë përfituesit kryesorë të këtij procesi transformues, e jo vetëm, por edhe shoqërinë akademike, botën e biznesit. Shpresojmë shumë që, në një mënyrë apo një tjetër, do të stimulojmë edhe filantropinë në rajonin tonë, e cila është ende në fazat e para, sepse jo çdo gjë mund ta ketë origjinën te mbështetja buxhetore apo te mbështetjet që mund të vijnë nga organizata e nga partnerë të ndryshëm, që operojnë në Shqipëri.

Edhe një herë tjetër: faleminderit për mbështetjen!

**Gramoz Ruçi** – Faleminderit, zoti Ministër!

Fjala për zonjën Spiropali.

**Elisa Spiropali** – I nderuar, zoti Kryetar!

Para jo më larg se dhjetë minutash, drejtuesja e seancës iu drejtua disa opozitarëve,

që dolën në këtë foltore, duke u thënë se duhet të flisnin për rendin e ditës.

E kuptoj gjykimin e drejtueses së seancës, por më lejoni të kujtoj se në këtë sesion parlamentar, deputetët e opozitës dhe drejtuesit e tyre në asnjë rast të vetëm nuk kanë folur dhe nuk kanë votuar për një ligj që ka qenë në interesin publik.

Shekspiri ka thënë: “E gjithë bota është një skenë, është një teatër”. Sigurisht, këta e kanë marrë këtë thënie të lavdishme të Shekspirit dhe e kanë shndërruar në: “E gjithë politika është një teatër”. Në fakt, e gjithë jeta e tyre politike është një teatër.

Këtu, në këtë foltore, një i pandehur u ngrit dhe foli për gjykata. U ngrit një komunist, që e reflekton komunizmin edhe në fijen e flokut, i cili foli për anëtarë byroje e për komunizmin që është gjallë. U ngrit një grabitës koncesionesh dhe foli për hajdutëri. Këtu nuk ka mbetur tradhtar pa folur për patriotizëm.

Ky është teatri që luajnë çdo të enjte. Për ta ilustruar me fakte, po ju them se në të gjithë sesionin parlamentar, po i marr me radhë projektligjet që nuk kanë votuar:

Nuk kanë votuar projektligjin “Për mbrojtjen e pakicave kombëtare në Republikën e Shqipërisë”, një nga projektligjet më të mira, më të forta, që na nderon në sytë e partnerëve tanë europianë.

Nuk kanë votuar projektligjin “Për shqyrtimin e vlefshmërisë ligjore të krijimit të titujve të pronësisë mbi tokën bujqësore”, i cili po ashtu përbën një nga pikat kyçe të zhvillimit të vendit.

Nuk kanë votuar projektligjin “Për strehimin social”, një nga ligjet më të rëndësishme, i cili i jep zgjidhje përfundimtare çështjes së strehimit në vend.

Nuk kanë diskutuar dhe nuk kanë votuar marrëveshjet, të cilat nuk po i marr me radhë: me Gjermaninë, me Maqedoninë, me njohjen e pensioneve, me Austrinë e me radhë.

Nuk kanë votuar projektligjin “Për diasporën”, por as nuk kanë diskutuar në lidhje me të.

Nuk kanë votuar projektligjin “Për statistikën zyrtare”, projektligjin për ratifikimin e “Marrëveshjes me Republikën e Francës”, e cila ishte po ashtu e rëndësishme për zhvillimin në Mesdhe; strehimin social e përmenda;

“Trashëgimia kulturore dhe muzetë”, projektligjin “Për Fondin Shqiptar për Zhvillimin e Diasporës”.

Këta zotërinj, të cilët vijnë këtu dhe flasin për gjithçka, përveçse për zhvillimin e Shqipërisë dhe integrimin, nuk kanë votuar as projektligjin “Për tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisë”, një ligj i rëndësishëm, i cili lehtëson agroturizmin në vend. S’duan t’ia dinë as për të e as për ndonjë ligj tjetër, që lidhet me integrimin europian të Shqipërisë.

Se për çfarë duhen zotërinjtë në këtë sallë të Kuvendit, ne e dimë edhe më mirë: duhen për të inskenuar Babalejt; duhen për të hedhur çizme e miell në këtë sallë të Kuvendit në momentin që zgjidhet Kryeprokuroria, një hallkë shumë e rëndësishme e reformës në drejtësi; duhen në këtë sallë Kuvendi apo nëpër komisione për t’i mësyre komisionet e për të penguar fizikisht zhvillimin e tyre; duhen për të bërë teatër me teatrin, i cili nuk e di si qëndron në këmbë në qendër të qytetit, pikërisht këta që nuk kanë investuar asnjë qindarkë të rëndësishme për kulturën e vendit, ndërsa tani që kultura është ringjallur, kujtohen të ngrihen nga varri arkeologjik.

Pra, në këtë sesion parlamentar, që rastis të jetë i pari për mua, nuk kam parë asnjë ide, nuk kam dëgjuar asnjë program, asnjë vizion, dhe nuk jemi përballur asnjëherë me njerëz të cilët, përveç shpifjes, kanë edhe ndonjë kredo tjetër.

E kanë kthyer sallën e parlamentit, komisionet dhe politikën në tërësi në një arenë llumi, ku vetëm e vetëm shpifin ndaj njerëzve me emër e mbiemër dhe duan medoemos t’i vënë damkën përfundimtare Shqipërisë.

Kanë rastin e madh për të ndryshuar rrugë. Komisioneri Hahn erdhi në Shqipëri dhe foli shumë qartë në lidhje me detyrat që ka Shqipëria deri në qershorin e ardhshëm. Rruga e Shqipërisë është përfundimisht e hapur drejt Bashkimit Europian. Pengesa e vetme që kemi, është mirëkuptimi mes nesh, mirëkuptimi si deputetë, si njerëz, si shqiptarë, si patriotë, që duam të përfaqësojmë njerëz të tjerë në këtë vend.

Në rast se nuk e kanë kuptuar mesazhin dhe në rast se për ta Komisioneri Hahn është një armik, i cili vjen këtu për t’i nxjerrë ata zbuluar, siç janë, atëherë është problemi i tyre, jo i komisionerit. Në rast se, sipas tyre, përfaqësuesja e lartë, Mogherini, është halla e një komunisteje,

problemi është i tyre dhe i qasjes që ata kanë mbi shpifjen! Në rast se presidenti Juncker, këtu më lejoni të kërkoj ndjesë, sipas tyre është një sarhosh, që nuk e drejton komisionin siç duhet, sepse nuk paska folur për Shqipërinë me gjuhën e tyre, atëherë problemi i madh i këtij vendi nuk janë këta përfaqësues të lartë, por janë pikërisht ata që duhet ta përfaqësonin në Kuvend.

Unë uroj që në sesionin e ardhshëm ne të kemi këtu një opozitë të përgjegjshme, e cila voton për ligjet që vijnë në Kuvendin e Shqipërisë, diskuton për to dhe, mbi të gjitha, mban përgjegjësitë e saj: të votojë projektligjin për magistraturën, reformën zgjedhore, që duhet ta bëjmë së bashku, dhe në qershor të jemi kryelartë përpara Bashkimit Europian dhe partnerëve tanë, të cilët nuk presin gjë tjetër, përveçse konsensusit politik.

Faleminderit!

**Gramoz Ruçi** – Faleminderit, zonja Spiropali!

Në emër të Grupit Parlamentar të Partisë Socialiste, fjalën e ka zoti Bushati.

**Ervin Bushati** – Faleminderit, zoti Kryetar!

Të nderuar kolegë,

Të nderuar qytetarë,

Para tri javësh me disa kolegë të nderuar të parlamentit ishim në një sesion punimesh të FMN-së në Vjenë, ku kishte përfaqësues të parlamenteve të ndryshme nga Mali i Zi, Maqedonia, Kosova, Serbia dhe Shqipëria, vende të një rajoni. Para disa kohësh këto vende nuk i shikonim në një tryezë 3-ditore duke mbajtur punime të përbashkëta, duke bashkëbiseduar dhe duke ngritur pyetje, por për shkak të proceseve që kanë ndodhur, të cilat kanë ulur në një tavolinë vende që e kanë pasur shumë të vështirë të komunikojmë dhe të flisim më parë me njëri-tjetrin, tashmë ato janë më se të mirëpritura. Në këtë kuadër, edhe mekanizmi i ri që propozohet sot mendoj se do të jetë shumë i nevojshëm për të harmonizuar bashkëpunimin, bashkërendimin, pse jo edhe projekte të përbashkëta midis vendeve, të cilat më parë nuk kanë pasur ura komunikimi, siç ishte Kosova me Serbinë, qoftë edhe Kroacia me Serbinë, apo vende të tjera, që kanë pasur vështirësi në komunikim.

Faza e sotme e zhvillimit të vendit, por edhe ajo e rajonit kërkon që vendet, të cilat shpeshherë kanë pasur problematika të mbartura

ndër shekuj, për arsye të përfitimeve qoftë sociale, por edhe ekonomike, të ulen në tryezë, të kapërcejnë ndasitë dhe të punojnë si një trup i vetëm. Prandaj, krijimi i Fondit të Ballkanit Perëndimor është më se i mirëpritur, sepse Shqipëria, Bosnje-Hercegovina, Mali i Zi, Maqedonia, Kosova dhe Serbia do të ulen dhe do të kenë projekte të përbashkëta.

Unë kam dy sugjerime të shkurtra.

Së pari, mendoj se formati, në të cilin do të bashkëpunojnë, të jetë i marketueshëm në mënyrë edhe më konkrete, më të prekshme, më të thjeshtë, më thithëse për të afruar sa më shumë të rinj, për të afruar sa më shumë shtresa apo grupe interesi, të cilat janë të interesuara, siç mund të jetë turizmi, sepse e bëjmë më të thjeshtë, më bashkëpunues, por edhe më përftues procesin.

Po shikojmë disa raste kur turizmi, sidomos ai alpin, po kombinon sot paketa të përbashkëta ndërmjet Malit të Zi, Kosovës, Shqipërisë, pse jo edhe Serbisë. Ka shumë të huaj që vijnë nga Europa Qendrore apo vendet nordike, që duan t'i shikojnë këto vende si një paketë, pra ta trajtojnë Ballkanin si një paketë e vetme turistike. Kjo duhet menduar si diçka e tillë. Pra, duhet të kemi një format të thjeshtë, të marketuar mirë, që të funksionojë edhe përtej parametrave politikë, duke pasur pse jo edhe një logo më mikpritëse, për të pasur një flamur bashkëpunimi shumë më të thjeshtë nëpërmjet rrjeteve sociale dhe projekteve.

Së dyti, në fakt, thuhet se krijimi i këtij fondi nuk ka kosto financiare. Ndërkohë, fakti që ne u kemi dhënë 72 mijë euro për 5 vjet, që është një kosto e munguar ekonomike e zyrave, përsëri është një kosto financiare, e cila do të fillojë të regjistrohet në bilanci e shtetit shqiptar.

Unë dua që nga viti i ardhshëm ministri i Jashtëm dhe ministri i Financave të flasin për të krijuar një fond të përbashkët, ndoshta duke kaluar në fillim shuma modeste, por fondit të bashkëpunimit i duhen dhënë edhe mjete financiare, që nesër të kemi disa projekte të përbashkëta; të ftojme disa të rinj nga të gjitha trevat e këtyre vendeve; të kemi disa projekte kulturore, të kemi disa projekte turistike, të kemi disa projekte kulinare; të kemi disa projekte etnografike e të tjera. Prandaj, dua që vitin e ardhshëm mundësisht të shikohen edhe hapësirat financiare nga ministri i Financave dhe ministri i

Jashtëm për të pasur projekte të sakta dhe me kosto financiare. Të paktën unë dhe Komisioni i Jashtëm, që kemi ardhur për të mbështetur këtë projektligj, mendojmë se janë shumë e nevojshme dhe duhen mbështetur.

Faleminderit!

**Gramoz Ruçi** – Atëherë, mbyllet debati për këtë projektligj.

Vazhdojmë me projektligjin “Për ratifikimin e marrëveshjes së ndryshimit ndërmjet Republikës së Shqipërisë, duke vepruar nëpërmjet Këshillit të Ministrave, dhe *Trans Adriatic Pipeline AG*, lidhur me marrëveshjen me qeverinë e vendit pritës”.

Zoti Ministër, keni fjalë.

**Arben Ahmetaj** – Faleminderit, zoti Kryetar i Kuvendit!

Dua të them disa fjalë për marrëveshjen në fjalë. Marrëveshja e Republikës së Shqipërisë me konsorciumin për ndërtimin e *Trans Adriatic Pipeline* ka qenë dhe mbetet një sukses i vazhdueshëm i bashkëpunimit të qeverisë me një investitor strategjik me rëndësi të veçantë jo vetëm për ekonominë e Shqipërisë, por edhe për ekonominë e rajonit, si dhe për futjen e Shqipërisë, nëpërmjet këtij investimi, në hartën gjeoenergjetike-strategjike.

Kjo marrëveshje përsërit regjimin fiskal në funksion të lehtësimit të marrëdhënies midis administratës tatimore dhe konsorciumit. E njëjta gjë ka ndodhur me regjimin fiskal të ndërtimit të hidrocentralit të Devollit. Pra, jemi duke thjeshtësuar marrëdhënien në reflektim të problematikës së rimbursimit të akumuluar në 5 vjetët e fundit. Kjo do të thotë se kompania bën në mënyrë rigorozë transparencë fiskale, duke deklaruar të gjithë nënkontraktorët e saj. Ndërkohë, për importet nuk do të paguajë TVSH, por do të konsiderohet, në bazë të regjimit brenda TVSH-së, me “reverse charge”, pra është e njëjta gjë si në rastin e hidrocentralit të Devollit.

Besoj se ky është një rast shumë i mirë për të folur për zhvillimet e ekonomisë shqiptare. Për këtë gjë do t'i referohem shumë shkurt raportit të fundit të Komisionit European për vendet kandidate dhe potencialisht kandidate, ku përfshihet edhe Shqipëria. Çfarë thotë Komisioni për zhvillimet ekonomike?! Ai thotë: “Shqipëria është rritur ekonomikisht 4,45% dhe kjo është rritja më e lartë në shumë e shumë vjet”.

E dyta, edhe kjo shumë e rëndësishme, brenda rritjes ekonomike flet për investimet në tërësi dhe për investimet e huaja dhe thotë atë që thotë INSTAT-i, Banka e Shqipërisë, të cilën e përsëritim edhe ne: “Në aspektin e kërkesës, rritja ka ardhur për shkak të rritjes së konsumit dhe rritjes së investimeve”. Pra, e gjithë ajo bolori fermentuese për rënie ekonomike tashmë ka tre vjet që provohet jo vetëm statistiksht, por edhe praktikisht në terrenin ekonomik. Pra, tregohet e kundërta e asaj që trumbetohet, pra e rënies ekonomike. Në të njëjtën kohë aty flitet edhe për eksportet në rritje me dy shifra.

Të nderuar qytetarë,

Praktikisht, kompanitë shqiptare kanë mundur të eksportojnë jo vetëm në rajon, por edhe në Bashkimin European. Rritja e eksporteve tregon se ekonomia shqiptare ka rritur konkurrueshmërinë dhe është 18,3%, pra rritja e eksporteve është me dy shifra. Me gjithë vlerësimin e lekut në raport me euron, që mund të ketë ngarkuar dhe diku mund të ketë dëmtuar eksportues të mundshëm për shkak të rritjes së volumeve dhe për shkak të rritjes së konkurrueshmërisë së ekonomisë shqiptare, volumet janë vetëm në rritje, vlerat janë vetëm në rritje dhe gama e eksporteve të produkteve shqiptare në rajon, në Bashkimin European dhe më gjerë është vetëm në rritje. Eksportet kanë qenë një nga pikat më të dobëta të ekonomisë shqiptare. Nuk po them se ky element është forcuar përgjithmonë, sepse është ende i brishtë dhe do të duhet të investojmë procedura, vëmendje dhe punë, në mënyrë që konkurrueshmëria e ekonomisë shqiptare në raport me eksportin të vijë në rritje dhe tregjet të zgjerohen.

Ndërkohë, flitet edhe për tregun e punës. Në fakt, tek tregu i punës kisha një sfidë për opozitën, por, fatkeqësisht, ajo, si zakonisht, mungon në çdo gjë. Komisioni European thotë se tregu i punës është përmirësuar në mënyrë të konsiderueshme për shkak të ekspansionit dhe rritjes së ekonomisë.

Dje po dëgjoja në Komisionin e Ekonomisë përfaqësuesit e opozitës që thoshin se rritja e punësimit nuk është reale. A e dini çfarë bëra?! Shikoni kutitë! Kam sjell të gjitha listëpagesat e Republikës së Shqipërisë, ta gjitha borderotë e Republikës së Shqipërisë.

Të dashur qytetarë,

Të dashur deputetë,

Në këto kuti janë të gjitha listëpagesat e qytetarëve shqiptarë që shkojnë në punë, dhe janë me kompani dhe me emra; janë 670 mijë qytetarë. Le t'i marrin të gjitha listëpagesat dhe t'i verifikojnë. Pra, të gjithë asaj bolorie fermentuese që punësimi nuk është real po i tregoj të gjithë listëpagesat e Republikës së Shqipërisë. Kam kënaqësinë t'ju lë kutitë, listat, borderonë e Republikës së Shqipërisë për të prekur me dorë dhe për të lexuar emra njerëzish, fytyra njerëzish, emra kompanish që punësojnë në Republikën e Shqipërisë, si dhe qytetarë shqiptarë të cilët kanë emra konkretë, punë konkrete, pagë reale, që dalin në mëngjes dhe shkojnë çdo ditë në punë, të cilën e kanë siguruar, të paktën mbi 35% e tyre, në mandatin e parë dhe në vazhdim të mandatit të dytë të qeverisë “Rama”.

Të dashur qytetarë, ju të medias, të dashur deputetë, ja ku është verifikimi: listëpagesat e Republikës së Shqipërisë, thënë shkurt, borderotë.

Të dashur miq, në këto bordero është emri i çdo të punësuarit në Republikën e Shqipërisë.

Do ta vazhdoj diskutimin për atë që thotë Komisioni për ekonominë e Shqipërisë.

Komisioni thotë se është ulur borxhi publik. A i keni dëgjuar budallallëqet dhe broçkullat: “U rrit borxhi publik.”?! Borxhi publik është në ulje dhe komisioni thotë: “Borxhi publik ka rënë nga viti në vit dhe po shkon në 3-mujorin e parë të vitit 2018 në 69%”. Mos harroni premtimin se në fund të vitit do të jetë nën 68% dhe konsolidimi fiskal do të vazhdojë deri në fund të këtij mandati, 60-63%, për ta shëndoshur përfundimisht dhe në mënyrë të pakthyeshme edhe këtë pjesë të financave publike.

Ndërkohë, dua të bëj një sqarim për qytetarët. Të përfitojë nga i dituri i paditur, që, faktikisht, ka vendosur rekord në hajdutëri, gënjeshtëri, vrasje dhe shkatërrim, i cili akuzoi qeverinë se ka ulur tatimin për lojërat e fatit, madje kam parë edhe portale që, për shkak të mosleximit ose moskuptimit të ligjeve, mund të jetë edhe kjo, thonë atë që tha boloria. Ja ku e keni ligjin e vitit 2015!

Të nderuar qytetarë,

Të dashur deputetë,

Ky ligj nuk ka ndryshuar. Ky ligj vendos konceptin, definicionin dhe mënyrën e tatimit. Çfarë ka ndodhur? Këta kanë dhënë Lotarinë Kombëtare. Ky hajduti këtu, që iku, dhe ai hajduti tjetër, pra të dy këta hajdutë, njëri kryetar komisioni i atëhershëm dhe tjetri kryeministër i atëhershëm, sollën një ligj në këtë parlament për Lotarinë Kombëtare, ku e taksonin 10%. Çfarë ka bërë ligji për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin për tatimin mbi të ardhurat? Nga 10%, ia ka bërë tatimin 15%, asnjë gjë tjetër nuk ka ndryshuar. Ja ku e keni, është publik, është i botuar e zeza mbi të bardhë dhe thotë që shkalla e tatimit edhe për Lotarinë Kombëtare do të jetë 15%, jo 10%!

Me padituri, injorancë, qëllimshmëri dhe hajdutëri vjen këtu dhe akuzon për ulje të taksimit. Asnjë gjë nuk ka ndryshuar, përveç rritjes nga 10% në 15% të tatimit mbi të ardhurat bruto, një definicion i shkruar në ligjin e vitit 2015, i pandryshuar që atëherë, i cili barazon tatimin e të gjithë të tjerëve me Lotarinë Kombëtare, i dhënë në një dorë ekskluzive nga Sali Berisha. Këtë bën ligji.

Për të sqaruar opinionin publik dhe për të hedhur dritë edhe në zhvillimet ekonomike, nuk po themi që ekonomia shqiptare është e dyta pas Gjermanisë dhe ka lënë mbrapa edhe Francën, nuk po themi nga këto idiotësira, vazhdojmë të them që në raport me pritshmërinë kemi absolutisht shumë për të bërë, por në raport me atë që gjetëm, jemi dita dhe kemi lënë mbrapa natën.

Faleminderit!

*(Drejtimin e seancës e merr zonja Vasilika Hysi)*

**Vasilika Hysi** – Faleminderit, zoti Ahmetaj!

Fjalën e ka deputetit Besnik Baraj.

**Besnik Baraj** – Faleminderit!

Në fakt, tema për të cilën doja të flisja mendoj se u ezaurua nga ministri, por në këtë kuadër dua të sjellë një shqetësim tjetër, që i përshtatet edhe ndjeshmërisë së qeverisë sonë, por edhe publikut në përgjithësi.

Këtë fundjavë, për arsye familjare, isha në Bajram Curri. Para pak vitesh, kur shkoja atje, ndieja një trishtim të thellë. Qyteti ishte i mbuluar me një hije vdekjeje, rrugët e shqyera në mes të qytetit, vende-vende të çara e me zgavra, të krijojnë përshtypjen se nga thellësia e tokës

vinin rënkimet e qindra të rinjve të vdekur, të vrarë për arsye nga më të ndryshmet, ku shpesh arsyet ishin edhe për motive politike. Si është e mundur, thosha me vete, që ky qytet është katandisur në këtë gjendje?! Si është e mundur që vendlindja e Presidentit dhe Kryeministrit të Shqipërisë për 14 vjet me radhë katandiset në këtë mënyrë?! Kontrasti midis bukurisë së natyrës, trishtimit dhe braktisjes së qytetit ishte tragjik.

Sot, falë ndërhyrjes dhe planifikimit të rehabilitimit të qytetit, tagër i rilindjes urbane, ky qytet ka një pamje komplet tjetër. Vlerësimin dhe ndryshimin e atmosferës e vije re edhe nga numri jo i vogël i turistëve, që ishin të pranishëm në qytet.

Morëm rrugën për në Valbonë. Në këtë pjesë me bukuri të rralla, ndoshta unikale në rajon, të kapte trishtimi i viteve më parë, faqe mali të qjerra, sikur ndonjë përbindësh kishte dashur të gërmonte për të shtrirë vrapin mbi perlën natyrore, Valbonën. Për nga turbullira, fundjavën e kaluar Valbona i ngjante lumit të Lanës, por më e keqja ishte se përbindëshi kishte bllokuar lumin me diga betoni, i cili gjarpëronte si gojë e stërmadhe për të thithur ujin, që do ta orientonin tubat e stërmëdhenj, duke e zhdukur lumin në segmente të caktuar në masën 90%. Katastrofa mjedisore ishte ulëritëse. Asnjë ligj i Republikës së Shqipërisë dhe jo më i Bashkimit Europian nuk është respektuar aty. Këto punime janë sa 1/12 e atyre që kishte parashikuar Sali Berisha, superpatrioti i Shqipërisë, që e do natyrën dhe ka dëshirë të udhëtojë në natyrë.

Ku janë zërat e kolegëve deputetë të PD-së, që kanë kaq muaj që flasin për teatrin dhe nuk thonë një fjalë për Valbonën? Teatri do të prishet për t'u bërë një më i bukur, më i përshtatshëm për artistët dhe publikun, por Valbona, ajo bukuri miliona vjeçare, po shkatërrohet falë projekteve famëkeqe të qeverisë "Berisha". Në Valbonë po ndërtohet shëmtimi. Pse nuk flisni, apo sepse ju me Berishën jeni autorë të 12 masakrave të projektuara vetëm në Valbonë? Nuk po flas këtu për zona të tjera të mbrojtura dhe me vlera mjedisore, që gjatë viteve që ju ishit në pushtet i shkatërruat.

Për fat të keq, në këtë vend shpesh kanë dominuar interesat personale dhe është kjo arsyeja që shpesh biznesi u bie me shqelma

dyerve të ministrave përkundrejt një përfitimi financiar.

Shteti e blen energjinë e prodhuar prej HEC-ve me çmim shumë të favorshëm për biznesin në raport me koston. Biznesi ka fitim të garantuar, por a ka rëndësi ekonomike kjo për vendin në tërësi? Roli i një HEC-i të tillë në një perlë turistike është i papërfillshëm për ekonominë shqiptare dhe ai që mbetet është shkatërrimi. Çfarë janë 5 apo 10 megavatë energji të prodhuara në Valbonë, përballë atij dëmi monstruoz?! Imagjinoni çfarë do të ndodhte nëse këto hidrocentrale do të inicioheshin nga qeveria socialiste! Flisni, kolegë deputetë të PD-së! Ju, gjoja, e doni këtë vend dhe përgjeroni për Teatrin dhe hallet e këtij populli, por, nga ana tjetër, me gjithë reduktimin drastik të numrit të hidrocentraleve në Valbonë nga qeveria socialiste, mendoj se dy ministratë, ajo e Energjetikës dhe e Mjedisit nuk kanë qenë koshiente në nivelin e legjislacionit shqiptar për të ngritur alarmin te Kryeministri, që asnjë HEC të mos lejohej në Valbonë, sepse janë këto dy ministri që e alertojnë dhe e informojnë kreun e qeverisë. Edhe pse lejet u dhanë nga qeveria “Berisha”, në çdo fazë të ndërtimit të tyre ka pasur dhe ka mundësi që të ndalohen.

Fare mirë, një ligj i ngjashëm si ai i teatrit mund të vijë në parlament për të pezulluar vazhdimin e ndërtimit në Valbonë. Le të jetë kjo një peshë edhe për kolegët e PD-së, në mënyrë që të provojnë sa e duan këtë vend. Mendoj se asnjë sakrificë politike nuk do të ishte e tepërt për të shpëtuar Valbonën. Ne duhet të japim atë mesazh që Fan Noli ka dhënë 100 vjet më parë: “U mësojmë brezave se ka vetëm një Perëndi që duhet t’i shërbejnë, Perëndia e njerëzimit, e njëjtë për të gjithë tributë, përfshirë edhe tributë politike”, e thënë ndryshe: “Le ta duam pak këtë vend, në mënyrë që ne, në mos na kujtoftshin për mirë, të paktën të mos urrehemi për të këqijat që i bëmë apo nuk i ndaluan dot, sikurse është rasti i Valbonës”.

Faleminderit!

**Vasilika Hysi** – Faleminderit, zoti Baraj!

Në emër të Grupit Parlamentar të Partisë Socialiste, fjalën e ka deputeti Ilir Beqaj.

**Ilir Beqaj** - E nderuar drejtuese e seancës,

Të nderuara kolege dhe kolegë deputetë,

Në fakt, projektligji që ka sjellë sot qeveria ndihmon vijimin normal të zbatimit të një

projekti shumë të rëndësishëm, atë të gazsjellësit *Trans Adriatik*, projekt i cili ka ecur me ritme shumë të mira.

Qeveria ka bërë maksimumin për të krijuar mjedisin e përshtatshëm, që të paktën shteti shqiptar të përmbushë të gjitha detyrimet ndaj kësaj nisme, e cila është përtej vendit tonë dhe shumë e vlefshme si për vendin tonë, edhe për të tjerët.

Ndërkohë, sot, nisur nga volumi shumë i madh financiar i të gjithë aktivitetit të projektit, qeveria ka gjetur një mënyrë më të thjeshtë për të mbyllur procedurat fiskale, njësoj siç kemi vepruar edhe me projektin e Devollit. Kështu që, përveçse duhet ta mbështesim, në mënyrë që ky projekt të vazhdojë me lehtësi punën e tij, është edhe momenti t’u bashkohemi atyre që prezantoi ministri i Financave dhe Ekonomisë, që, përtej asaj çfarë thuhet nga opozita, për fat të mirë vazhdojmë të kemi tregues të përmirësuar dhe rritje të ekonomisë, të investimeve të huaja, të konsumit, të tregtisë me jashtë, të zhvillimit të turizmit dhe të investimeve të brendshme.

Pavarësisht se një pjesë e opinionit publik mund të jetë e përqendruar në çështjet e zakonshme para sezonit të pushimeve, praktikisht edhe për këtë sezon qeveria vazhdon të jetë e angazhuar më shumë se kurrë në të gjithë sektorët, edhe në mbështetje të turizmit, që këtë vit, si asnjëherë më parë, të kemi 2 miliardë euro të ardhura nga vizitorët e huaj, me një shtesë shumë të vlefshme të shtuar në punësim. Prandaj, nuk na mbetet gjë tjetër, vetëm ta mbështesim qeverinë në këtë projekt.

Faleminderit!

**Vasilika Hysi** – Faleminderit, zoti Beqaj!

Këtu përfundon diskutimi për projektligjin “Për ratifikimin e marrëveshjes së ndryshimit ndërmjet Republikës së Shqipërisë, duke vepruar nëpërmjet Këshillit të Ministrave, dhe *Trans Adriatic Pipeline AG*, lidhur me marrëveshjen me qeverinë e vendit pritës”.

Kalojmë në çështjen tjetër të rendit të ditës, në projektligjin “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve”. Ky projektligj është shtyrë për në seancën e radhës.

Çështja tjetër e rendit të ditës është projektvendimi “Për miratimin e ndryshimeve të strukturës dhe organikës së Komisionit të

Prokurimit Publik”. Nuk ka emra të regjistruar për diskutim, është thjesht për votim.

Çështja tjetër e rendit të ditës është projektvendimi “Për një ndryshim në strukturën dhe organikën e Zyrës së Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale”. Edhe ky projektvendim është vetëm për votim, pasi nuk ka emra të regjistruar.

Këtu përfundojmë me çështjet e parashikuara në rendin e ditës.

Gjithashtu, kemi një projektvendim “Për ngritjen e nënkomisionit parlamentar “Për ndjekjen dhe mbikëqyrjen e zbatimit të ligjit nr. 12/2018 “Për vlerësimin kalimtar dhe periodik të punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës dhe Shërbimit për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat në Ministrinë e Brendshme”. Ky projektvendim është vetëm për votim.

Në kalendar është parashikuar edhe projektligji “Për profesionin e avokatit në Republikën e Shqipërisë”. Ky projektligj është për votim.

Të nderuar kolegë, sekretaria e seancave më bën me dije se Komisioni për Politikën e Jashtme ka propozuar në Kuvend projektrezolutën “Për reformën e politikës shtetërore për diasporën”. Shqyrtimi i kësaj rezolute do të bëhet në seancën e ardhshme plenare.

Të nderuar kolegë, 3 minuta pushim!

*(Rifillon seanca)*

**Gramoz Ruçi** – Të futet media brenda!

Rifillojmë seancën për të votuar projektligjet.

Hapet votimi për prezencën.

Mbyllet votimi.

75 deputetë të pranishëm.

Në fillim kalojmë në votimin e projektrezolutës “Për vlerësimin e veprimtarisë së Kontrollit të Lartë të Shtetit për vitin 2017”. Në mbështetje të nenit 78 të Kushtetutës dhe nenit 55 të Rregullores, kërkohet shumicë e thjeshtë votash. Procedura e votimit: një votim, me elektronikë, i hapur.

Hapet votimi.

Mbyllet votimi.

75 vota pro, asnjë kundër, asnjë abstenim.

Miratohet.

Kalojmë te projektligji “Për ratifikimin e marrëveshjes me vendin pritës ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Fondit të Ballkanit Perëndimor”. Në mbështetje të neneve 121 dhe 122 të Kushtetutës, ky projektligj kërkon shumicë absolute votash për miratim.

Hapet votimi në parim.

Mbyllet votimi.

75 vota pro, asnjë kundër, asnjë abstenim.

Miratohet në parim.

Kalojmë në votimin nen për nen.

Neni 1. Pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Neni 2. Pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Kalojmë në votimin në tërësi të projektligjit.

Hapet votimi në tërësi me elektronikë.

Mbyllet votimi.

75 vota pro, asnjë kundër, asnjë abstenim.

Miratohet.

Kalojmë te projektligji “Për ratifikimin e marrëveshjes së ndryshimit ndërmjet Republikës së Shqipërisë, duke vepruar nëpërmjet Këshillit të Ministrave, dhe *Trans Adriatic Pipeline AG*, lidhur me marrëveshjen me qeverinë e vendit pritës”. Edhe ky projektligj kërkon shumicë votash për miratim.

Hapet votimi në parim me elektronikë.

Mbyllet votimi.

75 vota pro, asnjë kundër, asnjë abstenim.

Miratohet në parim.

Kalojmë në votimin nen për nen me kartonë.

Neni 1. Pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Neni 2. Pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Hapet votimi në tërësi me elektronikë.

Mbyllet votimi.

74 vota pro, asnjë kundër, asnjë abstenim.

Miratohet në tërësi.

Kalojmë te projektvendimi “Për miratimin e ndryshimeve të strukturës dhe organikës së Komisionit të Prokurimit Publik”.

Në mbështetje të nenit 78 të Kushtetutës dhe 55 të Rregullores, ky projektvendim kërkon shumicë të thjeshtë votash për miratim.

Hapet votimi.

Mbyllet votimi.

75 vota pro, asnjë kundër, asnjë abstenim.

Miratohet edhe ky projektvendim.

Kalojmë te projektvendimi tjetër “Për një ndryshim në strukturën dhe organikën e Zyrës së Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale”. Në mbështetje të nenit 78 të Kushtetutës dhe 55 të Rregullores, edhe ky projektvendim kërkon shumicë të thjeshtë votash për miratim.

Hapet votimi me elektronikë.

Mbyllet votimi.

75 vota pro, asnjë kundër, asnjë abstenim.

Miratohet edhe ky projektvendim. Projektvendim “Për ngritjen e nënkomisionit parlamentar “Për ndjekjen dhe mbikëqyrjen e zbatimit të ligjit nr. 12/2018 “Për vlerësimin kalimtar dhe periodik të punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës dhe Shërbimit për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat në Ministrinë e Brendshme”. Ju bëj me dije se ligji nr. 12/2018 “Për vlerësimin kalimtar dhe periodik të punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës dhe Shërbimit për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat në Ministrinë e Brendshme” parashikon ngritjen e nënkomisionit parlamentar në përbërje të Komisionit për Sigurinë Kombëtare për të ndjekur dhe mbikëqyrur zbatimin e ligjit në fjalë. Është menduar që nënkomisioni të ketë në përbërje 7 deputetë, me raportin, 4 nga maxhoranca, nga PS-ja dhe 3 nga opozita, 2 nga PD-ja dhe 1 nga LSI-ja.

**Sekretari për Procedurat dhe Votimin**

**Alket Hyseni**

**Drejtori i Shërbimit të Botimeve  
Parlamentare  
Krenar Hajdëri**

Emrat e depozituar deri tani janë: Ermonela Valikaj Felaj, kryetare; emri i zëvendëskryetarit, që do të jetë nga PD-ja, nuk është depozituar; Pjerin Ndreu, anëtar nga PS-ja; Elona Gjebrea, anëtare nga PS-ja; Sadi Vorpsi, anëtar nga PS, si dhe dy vendet bosh, një nga PD-ja dhe një nga LSI-ja, të cilët janë të lutur t’i depozitojnë emrat. Në mbështetje të nenit 78 të Kushtetutës dhe nenit 55 të Rregullores, ky projektvendim kërkon shumicë të thjeshtë votash për miratim.

Hapet votimi me elektronikë.

Mbyllet votimi.

75 vota pro.

Miratohet.

Projektligji “Për profesionin e avokatit në Republikën e Shqipërisë” shtyhet për herën tjetër bashkë me dy projektligjet e tjera.

Mbyllet seanca për ditën e sotme.

Seanca tjetër do të zhvillohet ditën e hënë në orën 10:00.

*(Seanca u mbyll në orën 13:00)*

**Kryetari i Kuvendit**

**Gramoz Ruçi**